

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7804 E martë 26 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Kambanat po ushtojnë përditë e më fort për reformën e shumëpritur zgjedhore, domosdoshmëri urgjente për përparimin e demokracisë dhe celjen e negociatave ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
Zgjedhje të lira + Nëntë


Opinion *i* **Ditës**
Inderuar z.Wilton! E shijova shqipëri tuaj të bukur me theks verior, ndërsa flisnit në një takim në Shkodër, këtë fundjavë. Por ëmbëlsia e shqipes ...
Vijon në faqen 21

Nga KOÇO KOKËDHIMA
Imagjinoni zgjedhje si tonat në Anglinë tuaj, z.Wilton!




Instituti i Sigurimeve: Kategoritë që përfitojnë
Pagesë deri në 6 muaj për raport mjekësor, kriteret dhe dokumentacioni

Tabelat/ Për raportet mbi 14 ditë, paratë do të derdhen nga organet e sigurimeve në bazë të vjetërsisë në punë
Nga VOLTIZA DURO
Të gjithë ata persona që kanë probleme shëndetësore e si pasojë nuk janë të aftë për punë, mund të përfitojnë raport mjekësor deri në 6 muaj. Në legjislacionin e Sigurimeve Shoqërore përcaktohen edhe kriteret mbi bazën e të ...
Në faqen 11

OPOZITA/ KREU I PD: ASNJE PERPJEKJE FASADE, DO TE ÇLIROJME DREJTESINE **BASHA: DO ARRESTOHET DAKO. RAMA, PS: MOS BENI REPLIKA**

Djegia e mandateve, kryeministri: Të enjten seancë, vazhdojmë punën normalisht.
Mediu dorëzon mandatin. Murrizi shkarkohet si kreu i PD-së në Lushnjë



(Në foto) Kryetari i PD, Lulzim Basha, duke folur për gazetaret, ku deklaroi se po përgatitet arrestimi i Vangjush Dakos
Në faqet 2-3

PERLLOGARITJA
Ndryshon taksa e qarkullimit për makinat, afati dhe formula
Në faqen 6

APELI PER KRIZEN
KE: Palët politike të ulen në bisedime, djegia e mandateve dëmton demokracinë
Në faqen 4

DYSHIMI PER ATENTAT
Shpërthimi, plagoset rëndë 27-vjeçari në Gjirokastrë
Në faqen 8

SEANCA E GJYQIT
Gjykata pranon kërkesën, Balili përfiton gjykim të shkurtuar
Në faqen 9

KONCESIONI NE SHARRE



Skandali, ndërtuesve iu kërkohet të riblejnë dheun, biznesmenët: Akt i pastër korruptiv
Në faqen 7

Lista e pestë/ Ministria e Financave publikon dosjet e shqyrtuara në janar-tetor 2018

Emrat, të përndjekurit që marrin dëmshpërblimin

Dokumentet që i mungojnë në dosje çdo trashëgimtari që do këstin e tretë

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit



të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar ...
Në faqet 14-15

KRIZA POLITIKE MANDATET

Menjëherë pasi kreu i opozitës, Lulzim Basha paralajmëroi arrestimin e kreu të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, kreu i qeverisë Edi Rama u ka përcjellë një mesazh tjetër deputetëve të vet që të mos përfshihen më në debate e replika me përfaqësuesit e opozitës. Njëpërmjet një mesazhi të shkruar ai u ka përcjellë të vetëve në telefon porosinë që veç shmangies së debateve televizive me opozitën, të mos u përgjigjen as akuzave të tyre. Lideri i maxhorancës iu ka kërkuar të mos replikojnë me deklaratat e përgënjeshtrike ndaj akuzave e shpifjeve të përfaqësuesve të opozitës që ai i cilëson si "te ar-

Kryeministri, SMS deputetëve: Jo replika me të arratisurit e opozitës



ratisur". "Në vijim të komunikimit për refuzimin e daljeve me kolegët tanë të arratisur, në debate shterpë, të

cilat përveçse harxhojnë kot kohën e publikut, derdhin baltë e helm në tryezat e shqiptarëve, më duhet të shtoj se nuk do të replikojmë më në distancë me deklaratat e përgënjeshtrike ndaj akuzave e shpifjeve të tyre të pafundme", - thotë Rama në këtë mesazh. Më tej ai bën të ditur se vëmendja duhet të jetë tek njerëzit, por duke theksuar se mazhoranca nuk do t'i shmanget as akuzave, por do përgjigjet vetëm në momentet e përshtatshme. "E gjithë vëmendja jonë do të jetë tek njerëzit e

zakonshëm pa dallim dhe komunikimi ynë do të jetë për ta e me ta. Natyrisht nuk do t'i kursejmë as arratiakët në komunikimet tona, por vetëm kur kjo i duhet komunikimit me qytetarët. Le të merren kadrinjtë e kuzanët me doktrat e dëshpërimit të tyre dhe le të vijnë së bashku në zjarrin e mandateve të tradhtuara! Koka bën koka pëson, megjithëse në rastin e tyre koka e bën dhe trupi si gjithnjë e pëson?", - shkruhet në mesazhin e kryeministrit.



Protesta e opozitës

Zbardhen diskutimet, kryeministri ka kërkuar vijim e përgatitjeve për zgjedhjet

Djegia e mandateve, Rama në kryesi: Vazhdojmë punën, të enjten seancë

Shumica mbledh Kuvendin, do miratohet KLGJ dhe KLP

Pas një jave pushim për shkak të frikës nga protesta e opozitës, Kuvendi i Shqipërisë do të rikthehet këtë të enjte me mbajtjen e punimeve në seancë plenare. Kryesia e Partisë Socialiste e mbledhur gjatë mëngjesit të djeshëm ka marrë në shqyrtim situatën politike të krijuar në vend pas protestave të opozitës dhe vendimit të saj për të djegur mandatet e deputetëve, ndërsa ka vendosur që, krahas mbajtjes hapur të derës për dialog, të vijojë me jetën normale politike dhe atë të qeverisjes së vendit. Burime nga kjo mbledhje kanë bërë me dije se kryeministri, Edi Rama ka ripërsëritur edhe një herë se pavarësisht vendimit ekstrem dhe të paprecedent të opozitës, duhet të ecet përpara si me procesin qeverisës ashtu edhe ma të ligjëvënës. "Pavarësisht largimit të opozitës nga parlamenti duhet të vijojë puna normalisht për seancat parlamentare të të enjteve", - mësohet të jetë shprehur kryeministri Edi Rama në fjalën e tij para anëtarëve të kryesisë, ku i pranishëm ishte për herë të parë edhe zëvendësministri i Jashtëm, Gent Cakaj. Nga ana tjetër ai është shprehur se mazhoranca duhet të jetë e hapur për të dialoguar me opozitën, por gjithmonë brenda rregullave dhe ligjit, duke përjashtuar çdo mundësi për të plotësuar kërkesat për krijimin e një qeverie tranzicioni apo edhe për të shtyrë zgjedhjet vendore apo për të zhvilluar zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ndaj ai ka kërkuar nga kryesia që të vijojë puna përgatitore për zgjedhjet lokale të 30 qershorit dhe të merren të gjitha masat organizative siç është parashikuar edhe në axhendën politiko-organizative të Partisë Socialiste të mirat-



Kryeministri Edi Rama dhe zëvendësministri i Jashtëm, Gent Cakaj

HUMBJA E PASAPORTAVE, RAMA Mbledhje në ministrinë e jashtme

Kryeministri Edi Rama njëherësh ministër i Punëve të Jashtme ka zhvilluar dje një mbledhje me përfaqësuesit të kësaj ministrie ku ka diskutuar mbi problemën e pasaportave të vjedhura. Pak ditë më parë policia greke e Kakavijës bllokoi një numër të madh të pasaportave të reja të emigrantëve shqiptarë në vendin fqinj, që ishin dërguar nga Ministria jonë e Jashtme. Pasaportat ishin futur në çanta dhe pa asnjë shoqëruar të ministrisë ishin dërguar me linjën e autobusëve Tiranë-Athinë. Por gjatë kontrollit të policisë greke në Kakavijë, kjo dërgesë ka krijuar dyshime dhe çantat janë bllokuar.

thithjen e kandidaturave të ndryshme që mund të jenë kandidatë potencial për të përfaqësuar PS-në në zgjedhjet e ardhshme vendore. Në kuadër të përgatitjeve elektro-

rale kryesia ka diskutuar edhe mbi plotësimin e detyrave që ngarkon kjo axhendë sipas afateve të përcaktuara dhe në mënyrë të veçantë me zgjedhjen koordinatoreve elektorale për çdo qendër votimi dhe ngritjen e skemës së organizimit digital nëpërmjet mesazheve në whatsapp dhe SMS-ve me tekst. Gjithashtu, në këtë mbledhje është diskutuar, raportuar edhe mbi plotësimin e regjistratit digital të të dhënave të anëtarëve dhe të dhënave të tjera të përfitimëve dhe përfutjes nga politikat 6-vjeçare të qeverisë. Të gjitha këto në funksion të zgjedhjeve të ardhshme vendore. Gjatë mbledhjes së kryesisë grupi i punës i ngarkuar nga Asambleja Kombëtare për hartimin e Statutit të ri të Partisë Socialiste ka raportuar mbi punën e bërë deri më tani, në mënyrë që drafti të miratohet në kongresin e 30 marsit. Në përfundim të kësaj mbledhje, kreu i Grupit Parlamentar socialist, Taulant Balla, bëri të ditur se në seancën e së enjtes Kuvendi do të miratohet mes të tjerave edhe dy projektligje të rëndësishme që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, përkatesisht miratimi i strukturës së KLGJ dhe KLP.



Gjebreja: Opozita iku nga Kuvendi se ka frikë nga humbja në zgjedhje

Deputetja e Partisë Socialiste, Elona Gjebreja e ftuar në rubrikën "Opinion" në News 24 e ka cilësuar ngjarjen të trishtë vendimin e opozitës për të dorëzuar mandatet, sidomos në një kohë kur pritet një vendim aq i rëndësishëm, siç është vendimi për hapjen e negociatave me BE. Gjebreja ashtu si shumica e socialistëve është e mendimit se opozita e ka ndërmarrë këtë vendim ekstrem nga frika e reformës në drejtësi, por thotë se pavarësisht kësaj, PS-ja nuk do të lëkundet për ta cuar vendin në zgjedhjet e parakohshme. "Nëse qytetarët nuk kanë besim tek PS, janë ata që vendosin përmes votës dhe askush tjetër. Qeveria ka para një rrugë të dhimbshme me vështirësi, por kemi detyrim ta çojmë qeverinë para. Ata kanë frikë nga reforma në drejtësi. Edhe në 2017 kur fituam zgjedhjet nuk pati asnjë ankesë, kujtohen tani pas 1 viti e gjysmë e thonë se zgjedhjet nuk ishin të lira e të ndershme", - tha ajo. E pyetur nëse është e gatshme mazhoranca të dialogojë, Gjebreja tha se një mundësi të tillë opozita e ka djegur. "Ne kemi qenë që ata të futen në dialog, të pranojnë të futen në diskutime për reformën zgjedhore, si ti besojmë ne kur opozita nuk vjen në komision? Mund t'i adresonte vërejtjet e saj në këtë komision dhe të dilnim me një produkt të përbashkët. Të gjitha përpjekjet tona vajtën zero", - vijoi deputetja e PS.

POROSIA

"Pavarësisht largimit të opozitës nga parlamenti duhet të vijojë puna normalisht për seancat parlamentare të të enjteve", - mësohet të jetë shprehur kryeministri Edi Rama në fjalën e tij para anëtarëve të kryesisë, ku i pranishëm ishte për herë të parë edhe zëvendësministri i Jashtëm, Gent Cakaj.



Kryebashkiakët dorëzojnë mandatet? Shehi: Sulmi i opozitës do të jetë 360 gradë

Basha paralajmëron arrestimin e Dakos: Rama nuk shpëton dot

“Ndërkombëtarët të mos gënjejn, Rama do të largohet”

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, paralajmëroi mbremë arrestimin e kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako. Pas mbledhjes së Kolegjit të Kryetarëve, z.Basha deklaroi se ka informacione që po përgatitet arrestimi i kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako, për dosjen "339". "Ajo që dua të ndaj sot me ju është një paralajmërim i qartë dhe i prerë për Edi Ramën. Asnjë përpjekje fasadë nuk do ta shpëtojë dot nga përgjegjësia politike dhe ligjore që ka. Ai është kapur duke vjedhur zgjedhjet me bandat e krimin të organizuar. Orët e fundit janë intensifikuar informacionet se po përgatitet arrestimi i Vangjush Dakos", theksoi z.Basha. Sipas kreut të PD-së, arrestimi i tij nuk e shpëton kryeministrin Edi Rama. "Çdo shqiptar e kupton që zgjidhja e problemit në këtë vend vjen vetëm me largimin e Edi Ramës. Mund të flijohet Vangjush Dako, apo edhe njerëz të tjerë edhe më afër tij. Vendi nuk mund të mbetet më peng i njerëzve që e kanë placitur. Edi Rama duhet të largohet. Mjaft është mjaft! Tani që jemi krah shqiptarëve pa imunitet, përkrahja do vazhdojë. Kërkojnë një parlament që del nga vota e njerëzve. Prandaj është e rëndësishme që Dako të arrestohet, në mënyrë që mos i shkojë më ndërmend asnjë deputeti të asnjë lloj ngjyre. Beteja po avancohet, po avancohet edhe aty ku është, i struktur nga frika është gati të dorëzojë bashkëpunëtorët në krim. Edi Rama duhet dhe do të largohet. Opozita do vazhdojë e vendosur deri në çlirimin e Shqipërisë, drejtësisë dhe Partisë Socialiste", theksoi z.Basha.

MBLEDHJA

Pas lënies së mandateve, opozita po sheh mundësinë e tërheqjes së të zgjedhurve lokalë në të gjithë vendin. Qëndrimi i opozitës pritet të radikalizohet pas protestës kombëtare të 16 marsit, konfirmuan aleatët pas mbledhjes së djeshme në selinë e PD-së. "Këto do të diskutohen pas datës 16. Të jemi të sigurt që sulmi i opozitës do të jetë 360 gradë. Në të gjitha institucionet, në të gjithë hapësirën shoqërore, politike dhe



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

PARALAJMËRIMI

"Orët e fundit janë intensifikuar informacionet se po përgatitet arrestimi i Vangjush Dakos. Arrestimi i Dakos duhet të kishte ndodhur që kur dosja '339' faktoi që ai dhe të tjerë socialistë janë kapur në përgjime zyrtare të prokurorisë, duke bashkëpunuar me krimin e organizuar për të tjetësuar votën e qytetarëve të Durrësit dhe gjithë të të Shqipërisë", theksoi z.Basha.

Tri orë debate, Murrizi shkarkohet si kryetar i PD në Lushnjë

Pas vendimit për të shkarkuar nga radhët e partisë Myslim Murrizin, që nuk dorëzoi mandatin e deputetit, të dërguarit e PD-së në Lushnjë i komunikuan degës lokale shkarkimin e Myslim Murrizit si kryetar. Në mbledhjen e strukturave të PD-së në Lushnjë, dje në mesdite ishin të pranishëm deputeti i qarkut Enkelejd Alibeaj dhe sekretari organizativ i PD, Sait Dollapi. Në mbledhje pati debate se si do të riorganizohet tashmë kjo degë e PD-së, pas shkarkimit të Murrizit. Gjatë një prononcimi për median pas mbledhjes, Alibeaj u shpreh se dega e PD në Lushnjë dhe në Divjakë do të drejtohet në mënyrë kolegjiale nga anëtarët e kryesisë. "Nga 1 janë bërë shumë dhe do të jenë shumë edhe më shumë,



ata që do të vendosin për fatin e shqiptarëve dhe të lushnjëtarëve", deklaroi z.Alibeaj. Shkarkimi nga PD-ja i deputetit Myslim Murrizi erdhi pasi ai doli kundër vendimit të grupit për të djegur mandatin e deputetit. Tani Myslim Murrizi është deputet i Kuvendit, por nuk përfaqëson në të Partinë Demokratike. Veç çështjes

së kryetarit, për Alibeaj dhe në rëndësi ishte diskutimi edhe për vazhdimin e aksionit opozitar të Partisë Demokratike kundër qeverisë së majtë Edi Ramës. Mbledhja zgjati për rreth tri orë, ndërsa burimet thanë se pati edhe debate për mënyrën si do të bëhet riorganizimi.

Djedia mandateve, Mediu firmos dorëheqjen në parlament

Pas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, parlamenti i ka dërguar një shkresë të dytë ku rregulloi specifikimet teknike dhe sqaron procedurën që duhet të ndiqet, për vendet vakante që u krijuan nga dorëheqja e deputetëve të opozitës. Kryetari i Partisë Republikane firmosi djedre dorëheqjen pranë Kuvendit. Ndërkohë që parlamenti ia ka përcjellë dje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dorëheqjen e Fatmir Mediu. Mediu nuk e dorëzoi që në fillim mandatin e tij për shkak se ditën e protestës ndodhej në Vjenë në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së.



PD: Raportimet që u janë bërë ndërkombëtarëve, jo reale

Ish-deputetja e PD, Orjola Pampuri, deklaroi dje se raportet që kanë shkruar të ndërkombëtarët nuk janë reale. Pampuri u shpreh për "Ora News" se kur ndërkombëtarët do të kenë raportime të drejta, do të jenë në krah të opozitës. "Ndërkombëtarët janë të rëndësishme, por për momentin të gjithë informacionin që ata kanë, mendoj që nuk janë ato reale. Të gjitha ato informacionet, raportimet që kanë shkruar të ndërkombëtarët nuk kanë qenë ato reale dhe nuk janë ato çka në të vërtetë është në Shqipëri. Ne u tregojmë ndërkombëtarëve që jemi bashkë me qytetarët, sepse ata duan një Shqipëri si e gjithë Evropa. Ndërkombëtarët do të kuptojnë edhe në takimet që do të kenë në vijim, që të mos kërkojnë nga Shqipëria atë që nuk do të donin të ndodhte në vendin e tyre. Në vendet e tyre nuk tolerohet korrupsioni, nuk tolerohet shpëllimja e votës, nuk tolerohet bashkëpunimi i ministrave me bandat. Pra, të gjitha këto, një pjesë e mirë e tyre nuk i kanë të qarta dhe nuk dinë. Në momentin që do kenë raportime të drejta dhe të qarta jam e bindur që ndërkombëtarët do jenë në krah të opozitës", tha zj.Pampuri.



ndërkombëtare. Këtë do e përcaktojmë pas datës 16 mars, kur do të jetë dhe protesta e madhe", deklaroi Dashamir Shehi. Ndërsa Fatmir Mediu theksoi: "Opozita duhet të bëjë çdo gjë që do ta çojë Shqipërinë në binarët kushtetues dhe evropianë". Por, në bilok partnerët evropianë dhe amerikanë kanë kundërshtuar djegjen e mandateve të opozitës. Për këtë, Shehi tha: "Ne gjykojmë se ndërkombëtarët kanë marrë pozicio-

ni e vet, tradicional, klasik, që këtu para demokracisë vihet stabiliteti. I mirëkuptojmë. Por, gjykojmë se nga pozicioni i sotëm i demokrateve, ndryshe nga ai që ishte para tre muajve, ka një avancim shumë të madh. Kanë filluar ta kuptojnë edhe ata që sa të jetë zoti Rama do të ketë gjithnjë e më pak stabilitet, gjithnjë e më shumë drogë dhe krim të organizuar. Kështu që jemi edhe në rrugën për t'i bindur edhe ndërko-

mbëtarët për këtë punë". Në takimin e mble-dhur nga kreu demokrat, ishin prezentë kryetarja e LSI Monika Kryemadhi, kreu i PR Fatmir Mediu, ai i PAA Agron Duka, si dhe ai i LZHK-së, Dashamir Shehi. Tiranë pritet të ketë peshën kryesore për protestën e ditës së enjte para parlamentit. Për këtë arsye, Basha krahas aleatëve mbledhi edhe krerët lokalë të kryeqytetit, kurse në mbremje mbledhi Kolegjin e Kryetarëve të PD-së.

NDËRKOMBËTARËT

DIALOGU

Kuvendi pranon gabimin, korrigjon dorëheqjet e deputetëve të opozitës

Ka marrë zgjidhje ngërçi institucional me kërkesat për dorëheqje të deputetëve të opozitës. Kuvendi dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë sheshuar mosmarrëveshjet që dolën lidhur me njoftimet për deklarimin e dorëheqjeve të deputetëve opozitar, duke i hapur rrugë tashmë procedimit për zëvendësimin e tyre. KQZ-ja nuk pranoi të procedojë në lidhje me njoftimet e bëra ditën e premte nga ana e Kuvendit, duke pretenduar se formulimi i tyre ishte jo në përputhje me përcaktimet që bën neni 164 i Kodit Zgjedhor, pasi në shkresat e Kuvendit nuk bëhej konstatimi i krijimit të vakancave. Ndaj, ni-



sur nga kjo, KQZ-ja dje paradi të dërgoi Kuvendit një shkresë, ku i kthente pas njoftimit e paraqitura, ndërsa i kërkonte që t'i plotësoje ato në përputhje me detyrimet

ligjore. Kuvendi nga ana e tij ka pranuar problematikën e konstatuar nga KQZ dhe ka ribërë edhe një herë njoftimet për dorëheqjet, por kësaj here duke përcaktuar edhe vakancën. Menjëherë shërbimet e Kuvendit e kanë nisur dosjen e me 57 dorëheqje tashmë, pra duke shtuar edhe dorëheqjen e Fatmir Mediu, në KQZ dhe pritet që kjo e fundit të përcaktojë një seancë të posaçme në ditën e vijim për të vijuar me zëvendësimin e vakancave të krijuara. Por, burime nga KQZ-ja kanë bërë të ditur se pavarësisht këtij rregullimi, sërish procedura e ndjekur nga Kuvendi është problematike, pasi nuk ka zbatuar plotësisht përcak-

timet që bën neni 164 dhe që ka të bëjë pikërisht me faktin se dorëzimi i mandateve duhet të ishte bërë para Këshillit të Mandateve. "Deputeti deklaroi në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati", - thuhet ndër të tjera në pikën 1 të këtij neni. Pra, sipas këtyre burimeve, Kuvendi duhet që të paktën në mënyrë formale të kishte thirrur mbledhjen e këshillit dhe të pranonte dorëheqjet dhe më pas të autorizonte sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit që t'ia përcillte ato KQZ-së.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë ceremonisë së djeshme në Presidencë

PE: Qeveria dhe opozita të kapërcejnë situatën përmes dialogut konstruktiv

Kriza, KE: Palët politike të ulen në bisedime, presim dialog

Koçijaçiç: Djegia e mandateve dëmton demokracinë

DEKLARATA
"Mbani mend që ne presim që qeveria dhe opozita do të angazhohen në diskutime konstruktive për të tejkaluar situatën politike. Është një deklaratë shumë e qartë. Ne presim që të gjithë anëtarët e parlamentit të mbrojnë idealet dhe principet e demokracisë, të vazhdojnë të shërbejnë në parlament dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të evituar veprimet e dhunshme", - tha zj. Koçijaçiç.

Valentina Madani
Parlamenti Evropian shpreh shqetësimin për situatën politike të krijuar në Shqipëri, ndaj të mërkurën në Tiranë do të vijin 7 eurodeputetë të Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian, ku në axhendë do të kenë krizën politike në Shqipëri. Pikërisht të enjten, ditën kur opozita do të zhvillojë protestën e radhës, europarlamentarët do të kenë edhe konferencën për mediat. Kreu i delegacionit dhe eurodeputeti i Partisë Popullore, Tune Kalam, i ka kërkuar qeverisë dhe opozitës që të zgjidhin këtë situatë me anë të dialogut konstruktiv. "Ne dënojmë me forcë retorikën politike që nxit dhunën dhe i kërkojmë opozitës që të riangazhohet me jetën parlamentare. Qeveria dhe opozita duhet ta kapërcejnë këtë situatë nëpërmjet dialogut konstruktiv", - deklaroi z. Kalam. Delegacioni i PS-së gjatë vizitës në Shqipëri parashikohet të takojnë Presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama dhe kreun e PD Lulzim Basha. Pas Shqipërisë, 7 eurodeputetët do të udhëtojnë drejt Shkupit.



Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Koçijaçiç

VETINGU

"Në këndvështrimin tonë nuk ka indicie se përshpejtimi i reformës në drejtësi po cenon cilësinë e vetingut. Që prej fillimit, vetingu ka prodhuar rezultate konkrete dhe ne besojmë se vetingu po ndihmon për të luftuar korrupsionin në drejtësi", deklaroi zëdhënësja e KE-së.

gjithë anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë të mbrojnë idealet dhe parimet e demokracisë në parlament dhe të evitojnë masat për akte dhune dhe deklarata ndëzëse", deklaroi zj. Koçijaçiç. Gjithashtu, Koçijaçiç përcollë edhe mesazhin që qeveria dhe opozita duhet të dialogojnë për të zgjidhur këtë situatë. "Mbani mend që ne presim që qeveria dhe opozita të angazhohen në diskutime konstruktive, për të tejkaluar situatën politike. Është një deklaratë shumë e qartë", tha zj. Koçijaçiç. Zëdhënësja e Komisionit Evropian është pyetur edhe për kontestimet lidhur me kapërcimin e fazës së parë të disa prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk kanë hetuar dosje të nxehta të korrupsionit dhe nuk kanë justifikuar pasuritë e tyre. Ajo theksoi se Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit nuk po sakrifikon cilësinë e procesit për ta finalizuar sa më shpejt atë. Shtetet e Bashkuara, Institucionet e Bashkimit Evropian dhe OSBE e kanë cilësuar vendimin e opozitës për heqjen e mandateve, si cenim të demokracisë. Ambasdat e SHBA-ve dhe BE në Tiranë kanë apeluar javët e fundit që opozita dhe mazhoranca të dialogojnë në Kuvend.

Djegia e mandateve, Norvegjia dhe Sllovakia: Zgjidhje me dialog

Norvegjia dhe Sllovakia i kërkojnë qeverisë dhe opozitës që të ulen në dialog për të gjetur një zgjidhje. Ambasadori i Norvegjisë në vendin tonë, Per Strand Sjaastand, u shpreh se protestat janë një e drejtë e opozitës, por gjithashtu sipas diplomatit beteja politike duhet të zhvillohet edhe në parlament. "Jam i zhgënjyer nga vendimi i opozitës për të lënë mandatet. Por, uroj që opozita dhe mazhoranca të ulen në dialog për të zgjidhur këtë situatë. Është e vështirë që parlamenti të funksionojë pa opozitën. Mazhoranca mund t'i ketë votat, por një parlament pa opozitën nuk është demokratik", tha z. Strand Sjaastand. Nëse nuk arrihet një zgjidhje, tensionet politike do të kenë ndikim negativ në bisedimet për hapjen e negociatave të integritimit të Shqipërisë, vendim i cili parashikohet të merret në qershor. "Politika duhet të gjejë zgjidhje për situatën politike para qershorit, pasi kjo mund të ndikojë në vendimin e vendeve të BE për negociatat", theksoi ambasadori Sjaastand. Edhe ambasadori i Sllovakisë, Peter Spisiak, nga Çerriku i ka bërë thirrje opozitës që të kthehet në dialog. "Opozita duhet ta zhvillojë betejën politike në Kuvend. Sllovakia mbështet Shqipërinë në rrugën europiane", u shpreh z. Spisiak. 24 orë pas dorëzimit të mandateve të opozitës, Kuvendi ka dorëzuar në KQZ 56 mandatet e PD-LSI. Sipas rregulloreve, është KQZ-ja që duhet të shprehë për ndërprerjen e mandateve, por ky institucion ka kërkuar prej parlamentit saktësim të kërkesës, pasi nuk është shprehur për vakancat.



mandateve parlamentare nga partitë e opozitës, siç e ka bërë në Maqedoni. Koçijaçiç përsëriti qëndrimin se heqja dorë nga mandatet parlamentare nga ana e opozitës cenon demokracinë dhe procesin e integritimit dhe është kundërproduktive. "Sa i takon djegies së mandateve, vendimi i opozitës pengon seriozisht zhvillimin e demo-

kracisë në Shqipëri, sepse parlamenti është vendi ku reformat duhet të diskutohen, të merren dhe të çohen përpara dhe jo bojkoti. Këto vendime janë kundërproduktive dhe kundër zgjedhjes demokratike që qytetarët shqiptarë kanë bërë dhe minon progresin që vendi ka bërë në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Ne presim që të



DEKORIMI

Presidenti Meta përkujton 68-vjetorin e pushkatimit pa gjyq të 22 viktimave të pafajshme të "bombës" në ish-legatën sovjetike: "Brezat e rinj duhet ta njohin të vërtetën e së kaluarës së hidhur historike, që ajo të mos përsëritet më!"



Xhaçka: Kërcënimet më të mëdha, nga brenda vendit

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, zhvilloi një vitë zyrtare në Maqedoni, ku është takuar me homologen e saj, Radmilla Shekerinska. Xhaçka tha se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO garanton një rajon më të sigurt. "Nënshkrimi i Protokollit të Anëtarësimit në NATO nga Republika e Maqedonisë së Veriut është vërtet një moment i jashtëzakonshëm për të gjithë ne. Nga sot, i gjithë rajoni do të jetë më i sigurt, me shumë stabilitet dhe unë jam e bindur që të gjithë së bashku mund të shohim drejt së ardhmes me më shumë optimizëm", - u shpreh ministria Xhaçka, gjatë konferencës së përbashkët me homologen, Ludmila Shekerinska. Ministria Xhaçka foli në deklaratën e saj edhe për kërcënime që më së shumti shteteve po u vijnë nga brenda tyre. "Siç na tregoi edhe kalvari i vështirë që përjetoj Maqedonia e Veriut gjatë viteve të fundit, shpesh kërcënimet më të mëdha me të cilat na duhet të përballlemi në punën tonë nuk janë ato të jashtme, por ato që vijnë nga brenda. Sepse fatkeqësisht, siç ndodhi në Maqedoninë e Veriut e siç po ndodh sot në Shqipëri, në vendet tona ka jo rrallë forca që për interesat e tyre të ngushta, që s'kanë asnjë të përbashkët me interesat e qytetarëve apo vendeve tona, janë gati të rrezikojnë edhe stabilitetin, edhe zhvillimin, edhe të ardhmen tonë evropiane", u shpreh ministria Xhaçka.

Presidenti, thirrje politikës për qetësi: Bëhuni të përgjegjshëm në vendimet tuaja

"Bomba" në ish-legatën sovjetike, Meta dekoron 22 intelektualë të pushkatuar

"Është koha për reflektim, drejtësi dhe pajtim"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dekoroi dje me titullin e lartë "Për merita të veçanta civile" pas vdekjes, 22 intelektualët e pafajshëm të pushkatuar pa gjyq 68 vite më parë. 22 intelektualët e pafajshëm u pushkatuan pa gjyq 68 vite më parë me akuzën e hedhjes së "bombës" në ish-legatën sovjetike. Gjatë ceremonisë, Meta theksoi se intelektualët na mësuhan se urrejtja nuk ka vend pranë nesh, ndërsa shprehu mirënjohje për qëndresën stoike. Meta përkujtoi 68-vjetorin e pushkatimit pa gjyq të 22 viktimave të pafajshme të "bombës" në ish-legatën sovjetike: "Brezat e rinj duhet ta njohin të vërtetën e së kaluarës së hidhur historike, që ajo të mos përsëritet më. Për humanizmin e treguar, në vlerësim të mbajtjes gjallë të shpresës e kurajës së pashtrësme për të zbuluar e hedhur dritë mbi të vërtetën dhe si shembuj frymëzues fisnikërie u dekoruan Kadri Hysa, Fasli Hysa dhe Gëzim Mullaj (pas vdekjes), si dhe zotërinjtë Aleksandër Dhima, Hysen Shehu dhe Osman Kaceli. Ata janë shndërruar në shembuj të gjallë e frymëzues të sakrificave njerëzore dhe të shpirtit humanist shqiptar, në gjurmët e së shtrenjtës sonë, Shenjtores Nënë Tereza dhe sa e sa atdhetarëve të ndritur të kombit tonë, duke na mësuhan se urrejtja, përçarja, vëllavrasja dhe ndasitë nuk duhet të kenë më vend mes nesh. Për më tepër që dekorimi i këtyre qytetarëve të denjë e shqiptarëve fisnikë për merita të veçanta civile është një mirënjohje modeste ndaj altruizmit, atdheadashurisë dhe përpjekjeve të tyre besnike ndaj së vërtetës dhe qëndresës stoike përballë së keqes dhe padrejtësisë. Është koha për reflektim, drejtësi dhe pajtim! Përfjetshëm qoftë kujtimi i martirëve!", - u shpreh Presidenti Meta. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm deputetë dhe ish-deputetë, ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik e institucioneve shtetërore, kryetarja e AIDSH-së Gentiana Sula, familjarë dhe pasardhës të viktimave, studiues dhe historianë.

THIRRJA

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, bëri apel të fortë ndaj klasës politike, e cila

sipas tij, duhet të tregohet më e përgjegjshme për veprimet që ndërmer: Këtë deklaratë z. Meta e bëri dje në ceremoninë e bekimit të gurit të themelit të spitalit "Zonja e Këshillit të mirë" në Tiranë. Ai apeloj që klasa politike duhet të ruajë qetësinë. "Mesazhet dhe lutjet për paqe dhe vëllazërim, për qetësi dhe bashkëjetesë janë sot aktuale për shoqërinë tonë, për politikën dhe politikanët, për përgjegjësinë e madhe dhe historike që ata duhet të tregojnë në çdo vendim që marrin në interes të

së ardhmes evropiane dhe për kthimin e shpresës për të rehat dhe të rinjtë, që të ardhmen e tyre ta ndërtojnë në Shqipëri, bazuar në rruajtjen e vlerave më të mira familjare, shoqërore dhe kombëtare", theksoi z. Meta. I pyetur nga gazetarët nëse do të tentonte të organizonte një takim si ndërmjetës me dy kampet politike, kreu i shtetit nuk dha asnjë përgjigje.

TAKIMI

Presidenti i vendit, Ilir Meta, takoi në Tiranë Sekretarin e Shtetit të Atit të Shen-

jtit, Papa Françeskut, Kardinalin Pietro Parolin. Meta shprehu mirënjohjen e thellë për vëmendjen e madhe që Ati i Shenjtë, Papa Françesku dhe Selia e Shenjtë i kushtojnë Shqipërisë e shqiptarëve. "Lidhjet e hershme të miqësisë mes shqiptarëve e Selisë së Shenjtë, sot janë rigjallëruar dhe intensifikuar më shumë se kurrë", nënvizoi Presidenti Meta. Ndërsa duke iu referuar vizitës së Kardinalit Parolin në Tiranë, Presidenti Meta shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Selia e Shenjtë i ka dhënë dhe i jep zhvillimit të projekteve të ndryshme sociale, sidomos në arsim dhe shëndetësi. Të dy bashkëbiseduesit u ndalën edhe në zhvillimet më të fundit në rajonin e Ballkanit, duke nënvizuar rëndësinë e zhvillimit të dialogut, bashkëjetesës dhe bashkëpunimit për të ardhmen evropiane të rajonit. Gjithashtu kreu i shtetit ka ndarë me miqtë në "Facebook" momentet e takimit me Sekretarin e Papa Françeskut, ku mes tjerash shkruan: "Kënaqësi të mirëpres në Tiranë Sekretarin e Shtetit të Vatikanit, Kardinalin Pietro Parolin. Mirënjohës për mbështetjen e fortë dhe të vazhdueshme të Vatikanit për Shqipërinë dhe shqiptarët! Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Vatikanit, sot më të forta se kurrë".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë ceremonisë së djeshme për dekorimin me titullin e lartë "Për merita të veçanta civile" pas vdekjes të 22 intelektualëve të pushkatuar

Reagimi, PDIU: Iku koha kur copëtua Shqipërinë

Presidenti grek: Shqipëria nuk i ka braktisur kërkesat për çamët

Presidenti i Greqisë, Prokopis Pavlopoulos, akuzoi Shqipërinë se vazhdon të kërkojë të drejtat e çamëve. Ai përdori një gjuhë të ashpër dhe me tone kërcënuese ndaj Tiranës. Pavlopoulos tha se Shqipëria nuk i ka braktisur kërkesat, sipas tij, të pakonceptueshme të gjoja të drejtave të çamëve kriminelë. Ndërsa i bëri thirrje popullit grek të bashkohej për të mbrojtur pa lëshime çështjet kombëtare, Presidenti i Greqisë, Prokopis Pavlopoulos akuzoi Shqipërinë se vazhdon të kërkojë të drejtat e çamëve. Pavlopoulos përdori një gjuhë ekstreme dhe me tone kërcënuese kur tha se "Tirana zyrtare nuk i ka braktisur kërkesat sipas tij



hakmarrëse. Qëndrimi ynë kërkon respektin e së drejtës dhe të historisë", - tha Pavlopoulos. PDIU reagoi dje pas disa deklaratave të identitetit grek Prokopis Pavlopoulos. Përmes një deklaratë, PDIU shprehet se presidenti grek po shfaqet së bashku me Agimin e Artë si një minishencë e qarqeve nacionaliste dhe pasardhës i Napolon Zervës. Sipas PDIU, Presidenti grek është përfaqësuesi më i tipik i hipokrizisë dhe i standardeve të dyfishta të një shteti shovinist me shqiptarët. "Pavlopoulos, ka iku koha kur e copëtua Shqipërinë dhe masakrua Çamërinë. Ky është shekulli i shqiptarëve dhe Çamëria ka zot!" - thekson PDIU.

Zbardhet udhëzimi i Ministrisë së Financave: Vlefshmëria, 365 ditë kalendarike

Ndryshon taksa e qarkullimit për automjetet, afati i ri

Shembuj për llogaritjen e taksës së automjeteve

Ndryshon afati për vlefshmërinë e taksës së vjetore të qarkullimit të automjeteve. Ndryshe nga deri tani që taksa ishte në bazë vjetore, pra përfundonte me mbarrimin e vitit, me ndryshimet e fundit, taksa ka vlefshmëri 365 ditë kalendarike. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj ka firmosur udhëzimin nr. 9, datë 20.2.2019, ku janë përfshirë disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "për taksat kombetare", ku përfshihet edhe ndryshimi në taksën vjetore të automjeteve. Në pikën e parë të udhëzimit përcaktohet se, "detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Detyrimi i taksës paguhet për vitin kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor) për të cilin ka lindur detyrimi. Taksa e paguar në vitin aktual, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet, ka vlefshmëri 365 ditë". Madje, ndryshimi në udhëzimin shoqërohet edhe me shembuj. Në shembullin që ilustron ndryshimin ligjor thuhet se, "pronari i mjetit paraqitet më datë 11.2.2019 për të paguar taksën e vitit 2019, pra detyrimin e taksës për periudhën nga 1.1.2019 deri më 31.12.2019. Afati i vlefshmërisë së kësaj taksë është deri më 11.2.2020".

REGJISTRIMI

Sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave, mësohet

Motomjete, autovehikula, automjete për transport të përzjer		Të gjitha llojet e tjera		Autobusë	
Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

se mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën vjetore të mjeteteve të përdorura (TVMP), pavarë-

sisht datës së muajit. Gjithashtu, për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohet të bëhet njëkohë-

ISHTE

2.3.1 Taksa vjetore e mjeteteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik dhe ka vlefshmëri 365 ditë.

BËHET

2.3.1 Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Detyrimi i taksës paguhet për vitin kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor) për të cilin ka lindur detyrimi. Taksa e paguar në vitin aktual, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet, ka vlefshmëri 365 ditë.

sisht edhe procedura e regjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimet për TVMP llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e regjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimit.

SHENBULLI

Pronari i mjetit paraqitet më datë 11.2.2019 për të paguar taksën e vitit 2019, pra detyrimin e taksës për periudhën nga 1.1.2019 deri më 31.12.2019. Afati i vlefshmërisë së kësaj taksë është

deri më 11.2.2020". b) Pas fjalive me përmbajtjen: "Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën vjetore të mjeteteve të përdorura (TVMP) pavarësisht datës së muajit", shtohet fjalia "Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohet të bëhet njëkohësisht edhe procedura e regjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimi për TVMP llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e regjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimit".

FORMULA E TAKSËS

Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzininë. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj taksë. "Viti i vjetërsisë" është diferenca ndërmjet vitit, kur mjetit i lind detyrimi për të kryer pagesën e taksës me vitin e prodhimit.

Indeksi i shëndetit nga "Bloomberg"

Shqipëria fiton 7 vende krahasuar me vitin 2018



e cila ka ngjitur 7 shkallë nga të dhënat e një viti më parë. Indeksi klasifikon kombet bazuar në variablat duke përfshirë: jetëgjatësinë duke studiuar përdorimin e duhanit dhe obezitetin. Gjithashtu, merr në konsideratë faktorët mjedisorë, duke përfshirë aksesin në ujë të pastër dhe kanalizimet. Spanja ka jetëgjatësinë më të madhe midis kombeve të Bashkimit Europian dhe ndjek vetëm Japoninë dhe Zvicrën në nivel glo-

bal, tregojnë të dhënat e Kombeve të Bashkuara. Ekonomitë subsahariane përbënin 27 nga 30 vendet jo të shëndetshme në renditje. Haiti, Afganistani dhe Jemini ishin shtetet e tjera, që renditeshin më poshtë në këtë klasifikim. Mauritius ishte më i shëndetshmi në grupin e nën-Saharasë, në vendin e 74-t në nivel botëror, pasi kishte normën më të ulët të vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse në një rajon.

"Sytë", nga arsimiti profesional

Denaj: Të përputhet kërkesa me ofertën



punës", tha ministrja Denaj. Për vitin 2019, target është trajnimi i rreth 20 mijë punëkërkuessë të papunë. "Targeti për këtë vit është rreth 20 mijë punëkërkuessë që do të trajnohen. Do të trajnohen pranë qendrave të formimit profesional. Në atë rast dhe përforcimë bash-

këpunimin e zyrës së punës me qendrat e formimit për të përfunduar dhe aftësitë e qendrimit në punë të këtyre qytetarëve, qoftë të të rinjve, qoftë të qytetarëve të moshave të tjera", tha drejtorja e përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimi, Elira Çausi.

Projektet që vijnë përmes ofertave të pakërkuar në sektorin infrastrukturor do të shfuqizohen deri në 31 dhjetor të vitit 2021 e më pas do të rikthehen si mundësi për biznesin. Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka shqyrtuar nen për nen ligjin "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", ndërsa ka ndryshuar kërkesën e Ministrisë së Financave që këto lloj



Oferta e pakërkuar, vetëm moratorium

Rikthehet në vitin 2021, rrëzohet propozimi për HEC-et

projektet të shfuqizohen përgjithmonë. Ndërkaq, komisioni ka shqyrtuar edhe propozimet e ardhura nga shoqëria civile, që kërkojnë shfuqizimin e ofertës së pakërkuar edhe për hidrocentralet, për shkak edhe të ek-

speriencave negative që kanë vendet europiane në këtë drejtim. Ndryshimet e tjera të propozuara nga shoqëria civile u konsideruan nga zëvendësministria e Financave si të rregulluara nga legjislacioni aktual, por

deputetët kërkojnë që ato të përfshihen edhe në ligj si garanci për zbatimin e tyre. Ndryshimet do të diskutohen edhe nga komisioni i Ekonomisë dhe Financave e më pas do të kalojnë për miratim në seancë plenare.

Ministria e Mjedisit: Dherat të çohen në landfill dhe të riblihen

Skandal tjetër në Sharrë, ndërtuesve iu kërkohej të riblejnin dheun

Allmuça: Ky është një akt i pastër korruptiv

Që prej vitit 1998, Fatmir Allmuça ka nisur të ushtrojë aktivitetin e tij në sektorin e ndërtimit në Shqipëri. Paralelisht ka krijuar edhe një kompani për transportin e dherave. Por, që prej 7 muajsh, dy bizneset e tij dëmtohen nga vendimi i koncesionarit të Sharrës, që e detyron atë si ndërtues t'i shkarkojë dherat në landfill duke paguar tarifën prej 480 lekë/ton. "Kjo situatë na gjeti tërësisht të papërgatitur dhe asnjë njoftim nga asnjë institucion shtetëror. Unë nuk mund të them me përgjegjësi se nga inskenohet dhe nga drejtohet, por ky është një akt i pastër korruptiv. E gjithë puna ime është në dy drejtime si kompani ndërtimi, unë merrem me ndërtimet drejtpërdrejt vetë, por njëkohësisht merrem me transportin e dherave. Deri para 7 muajsh dherat grumbulloheshin në disa pika. Secili kishte një pronë të vetën. Unë kam pasur një pronë timen, ku i sistemoja dherat", shprehet Fatmir Allmuça për "News 24". Penalizimi i biznesmenit Allmuça nuk përfundon në Sharrë. Allmuça mendoi të ndërtonte edhe një fermë për të vënë në punë dheun e pakontaminuar që nxirrte nga hapja e gropave të ndërtimit, një ide që në vend ta zhvillonte e t'i sillte fitime, i krijoi probleme.

REAGIMI

Ministria e Mjedisit i bëri të ditur se dherat e përfuturara nga puna në ndërtim nuk mund t'i përdorë për qëllimin e tij pa i çuar më parë në landfill, nga ku duhet t'i blejë sërish. "Kur bëj kërkesë dhe i them dua ta vendos pronën në punë më thonë duhet t'ia marrësh dherat landfilit. E keqja më e madhe është se për të marrë lejen në shtet, duhet t'i drejtohem landfillit. Unë di që landfilli është shoqëri koncesionare, të cilën e ka përfutur nga shteti shqiptar. Nuk mund të detyrohem që dheun i pakontaminuar të dërgohet atje. Këtu dhera të pakontaminuara ne kryesisht i vinim në punë dhe i shisim dhe këtu qëndron problemi më i madh. Nëse unë dua të vendos ta bëj një pronë timen produktive, dua ta mbush me dhe



Biznesmeni Fatmir Allmuça



Landfilli i Sharrës

dua të bëj sistemimin e gjelbërimit në x pronë, qoftë edhe në objektet që ndërtoj vetë, i bie nuk kam të drejtë, por duhet të shkoj në landfill ta blej dhe kjo është gjëja më absurde që mund të ndodhë", thotë ndërtuesi

Allmuça. Skandali i blerjes së dherave nga biznesmenët që vetë i kanë shkarkuar, i shtohet atij të aferës me tarifën shtesë të koncesionarit të Sharrës. Për çdo metër që shkarkon dhera apo mbetje ndërtimore, koncesionari

merr 480 lekë/ton, ndërkohë që merr nga bashkia 29 euro për çdo ton mbetje organike, të prodhuar nga banorët e kryeqytetit dhe zonave përreth. Për këtë tarifë shtesë, "News 24" kërkojnë shpjegim nga koncesionari i incenera-

torit të zonës së trajtimit të mbetjeve "Integrated Energy B. V". Nëpërmjet një email-i shumë të shkurtër, koncesionari shpjegon se tarifa për kamionet që deponizojnë dhera dhe mënyra e përcaktimit të saj janë vendosur

nga landfilli me miratimin e Bashkisë së Tiranës. Për këtë aferë kanë reaguar përfaqësues të bizneseve dhe shumë ndërtues në vend, të cilët e cilësojnë një vendim me natyrë klienteliste dhe korruptive.

Nisin auditimet energjetike

Gati certifikimi i audituesve të parë

VENDIMI

Auditimi energjetik është një detyrim për çdo person juridik, publik ose privat që kategorizohet si konsumator i madh i energjisë, por pavarësisht se ky është një detyrim që përcaktohet në ligj që prej vitit 2015, ky proces nuk ka nisur ende.

këtij procesi. Ndërkohë, ndryshimet ligjore sjellin edhe një sërë specifikimesh për revokimin e licencave të tyre, duke i dhënë të drejtën Agjencisë së Eficiencës së Energjisë për të

nisur këtë proces në rast të shkeljeve të konstatuara. Sipas ndryshimeve ligjore, ky proces mund të nisë në rastin që provohet se në procesin e auditimit energjetik janë shkelur



dispozitat ligjore si dhe në rastin kur provohet se audituesi bën publik informacionin dhe të dhënat e shoqërisë, si dhe sekretet tregtare të konsumatorëve, me të cilat ai është

njohur për shkak të auditimit. Revokimi i licencës bëhet për një periudhë 3-vjeçare, ndërkohë që në rast përsëritjeje, subjekti fizik apo juridik nuk ka të drejtë riaplikimi.

Autori u dërgua në gjyq, nën masa të rrepta sigurie

Burri masakroi bashkëshorten me thikë, familjet Musta e Çaushaj kërkojnë kujdestarinë e 2 fëmijëve

FIER - Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Fierit dje është zhvilluar seanca gjyqësore e radhës në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur më 2 janar të këtij viti në Ballsh, ku 34-vjeçari Gazment Musta masakroi me thikë bashkëshorten e tij, Gentianën dhe kumatën 18-vjeçare Merisa Çaushaj. Në këtë seancë ishin të pranishëm të afërmit të familjeve Musta dhe Çaushaj, të cilët kanë kërkuar kujdestarinë e dy fëmijëve të mitur 3 dhe 10

vjeç, të mbetur jetimë. I pranishëm në seancë ishte edhe Gazment Musta, autori i ngjarjes, i cili nën masa të rrepta sigurie është risjellë në sallën e gjyqit. Gjithashtu, në seancë mori pjesë dhe kujdestarja e dy fëmijëve të çifitit, të cilët që pas vrasjes së nënës së tyre jetojnë në fshatin SOS. Mësohet se përfaqësuesja e fshatit SOS është shprehur gjatë fjalës së saj se kërkohej intervista e së miturës, pa prezencën e palëve, pasi gjendja e saj mund të agravohej. Ndaj, është kërkuar që në seancën

e radhës të jetë e pranishme edhe vajza J.Musta. Daja i fëmijëve, Gjysmir Çaushaj, i përfaqësuar në këtë seancë nga avokatja Dorjola Ibrahimimi, ka kërkuar kujdestarinë e vajzës dhe djalit të motrës së ndjerë, në mënyrë që të kujdeset për ta. Po të njëjtin gjë kanë bërë edhe gjyshërit e fëmijëve, nga babai, Bedri dhe Lumturi Musta. Me dy kërkesa të veçuara, drejtuari Gjykatës së Fierit, të dyja palët kanë kërkuar që të kujdesen për fëmijët. Mësohet se gjyqtare e çështjes është Arta Duka,



Autori i vrasjes, Gazment Musta, me bashkëshorten

e cila u ka lënë edhe pak kohë palëve për të dhënë provat e kërkuara, të cilat lidhen me kujdestarinë e vogëlushëve. Edhe në seancën e parë përgatitore, që

u zhvillua në 4 shkurt, qëllim ka qenë sqarimi i rrethanave të çështjes, ku i pranishëm ka qenë po ashtu edhe vetë autori i ngjarjes, Gazmend Musta.

Dyshime për atentat. Në 2016-ën, vëllai i të riut vrau kushërinin për borxhin 10.000 euro

Shpërthen eksplozivi, plagoset rëndë bariu 27-vjeçar në Gjirokastrë

Vitjon Luka dërgohet me urgjencë në Tiranë

GJIROKASTËR

Një 27-vjeçar nga fshati Shtëpëz i Gjirokastrës ka mbetur i plagosur rëndë me një sasi lëndë plasëse. Bëhet fjalë për të riun Vitjon Luka, i cili është transportuar me helikopter për mjekim në spitalin e Traumës në Tiranë. Mësohet se ai ka pasur dëmtime të rënda në kokë dhe fytyrë si pasojë e shpërthimit, ndërsa ende janë të paqarta rrethanat e plagosjes së bariut mesditën e djeshme. Burimet në lidhje me këtë ngjarje janë kontradiktore dhe nuk dihet nëse bëhet fjalë për një incident apo atentat. Sipas policisë, ky shtetas është dëmtuar me lëndë plasëse në një kullotë, në vendin e quajtur "Hani", në Subash, duke ruajtur bagëtitë, pasi duke ecur ka shkelur lëndën plasëse. Por ky variant i policisë rrëzohet, pasi i riu është dëmtuar vetëm në kokë. Ndërkaq, burime nga spitali rajonal "Omer Nishani" në Gjirokastrë fillimisht bënë me dije se lëndë plasëse ishte vendosur në makinën e të riut, ndërsa më pas u tha se eksplozivi gjendej në kasollen e ngritur pranë kullotës. Një burim tjetër nga policia pohoi se 27-vjeçari ka gjetur përtokë një pako të mbështjellë dhe e ka hapur lëndën plasëse, që më pas ka shpërthyer duke shpërthyer të riun që është dërguar me urgjencë në Tiranë. Sipas këtij burimi, vendosja e lëndës plasëse ka qenë e qëllimshme, ndërsa dyshohet se kjo ngjarje vjen si hakmarrje e një vrasjeje që ka ndodhur më 22 mars të vitit 2016 në kthesën e fshatit "Andon Poci", ku autor ka qenë Enërik Lluka, vëllai i Vitjon Llukes të plagosur rëndë ditën e djeshme. Tre vjet më parë, vëllai i Vitjon Llukes, Enërik Lluka qëlloi me armë zjarri të kushërinjtë e tij të dytë, Dorian Luka, i cili mbeti i pajetë dhe Birbil Lluka, i plagosur. Në atë kohë u tha se kushërinjtë kishin një borxh të pash-




lyer me njëri-tjetrin, prej 10 mijë eurosh. Enërik Lluka është shpallur në kërkim policor dhe dy vjet pas kësaj ngjarjeje ende nuk është arrestuar nga policia. Mbetet ende për t'u qartësuar nëse dy ngjarjet kanë lidhje me njëra-tjetrën.

VRASJA NË 2016-ËN

Pasditja e së martës së 22 marsit 2016 ka rezultuar fatale për dy vëllezërit Dorian dhe Birbil Lluka, përkatësisht 29 dhe 31 vjeç. Ngjarja e rëndë ndodhi në afërsi të fshatit "Andon Poci", pjesë e njësisë administrative Cepo në Gjirokastrë; në aksin nacional Gjirokastrë-Kakavijë. Autori i ngjarjes, kushëri i dytë i tyre, Enërik Lluka, 28 vjeç, është i biri i një ish-efektitiv policie në Drejtorinë e Policisë qarku Gjirokastrë, ndërsa dy vëllezërit Dorian dhe Birbil Lluka, nipat e të

shoqes së ish-kryetarit të Komunës Lazarat, Dasha Aliko. Një borxh i pashlyer duket se ka qenë edhe shkak i konfliktit mes kushërinjve Lluka. Sipas banorëve të zonës, katër të rinjtë, të afërm me njëri-tjetrin shoqëroheshin pothuajse përherë bashkë, por më problematik mes tyre ka qenë 28-vjeçari Enërik Lluka. Ai u ka kërkuar një shumë prej 10 mijë euro për të blerë automjetin tip "Benz" me targa AA 006 IY, i njëjti automjet i gjetur në vendin e ngjarjes. Në kryqëzimin që ndan aksin nacional Gjirokastrë-Tepelenë me fshatin Humelicë në perëndim dhe fshatin Andon Poci në lindje, dy vëllezërit Lluka janë ndeshur me Enërik Llugin. Të dyja palët ndodheshin në makina, dy vëllezërit i kanë kërkuar paratë e borxhit Enërik



Dorian Lluka i vrarë në 2016-ën



Birbil Lluka i plagosur në 2016-ën

Llukes. Në debat e sipër, dy vëllezërit e kanë kërcënuar me thikë 28-vjeçarin. Ky i fundit ka mundur t'u shpëtojë nga duart dy vëllezërve dhe ka hyrë brenda në makinën e tij, nga pjesa e pasagjerit, ku ka rrëmbyer pistoletën dhe ka qëlluar në drejtim të tyre. Debatit për kthimin e borxhit ka nisur më herët në qytetin e Gjirokastrës. Në kthim për në banesë, Enëriku u kishte zënë vëllezërit për të makinë. Gjatë debatit, ai nxjerr pistoletën nga makina dhe qëllon në kokë Dorianin, ndërsa i vëllai Birbilin plagoset rëndë. Enërik Lluka menjëherë pas krimit u largua në drejtim të lumit dhe u shpall në kërkim nga policia. Dy ditë pas ngjarjes, policia e Gjirokastrës vuri në pranga dy persona të tjerë me akuzën e moskallëzimit të krimit. Emiljano Vocka, 23

vjeç, banues në Humelicë, Gjirokastrë dhe Samuel Jaçe, 29 vjeç nga Gjirokastra kanë qenë të vetmit dëshmitarë okularë në vendin e ngjarjes, pasditën e 22 marsit 2016. Të pranishëm në konfliktin mes palëve, ata nuk kanë ndërhyrë për të parandaluar vrasjen. Vocka dhe Jaçe transportuan me makinën e vëllezërve Lluka, viktimën Dorian Lluka në spitalin rajonal të Gjirokastrës, ndërkohë që i plagosuri Birbil Lluka u transportua për në spital nga një automjet i rastit. Pas kësaj ngjarjeje, familja e autorit të vrasjes së dy vëllezërve u mor nën mbrojtje policore. Ngjarja e mesditës së djeshme së 25 shkurtit, risolli në vëmendje këtë konflikt, duke ngritur dyshimet për një hakmarrje të mundshme pas hasmërisë mes anëtarëve të një fisi.



KLP, opozitës: Kërkesa për shkarkimin e Arta Markut do t'i kalojë KAP

TIRANË - Kreu i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahim, u ka kthyer përgjigje kërreve të grupeve parlamentare të PD-së dhe LSI-së, në lidhje me kërkesën e tyre për shkarkimin e Prokurorisë së Përgjithshme, Arta Marku si dhe nisjen e hetimit disiplinor ndaj saj. Ibrahim ka sqaruar se kompetencën për të nisur hetim disiplinor ndaj kryeprokurores së përkohshme e ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Duke qenë se ky institucion ende nuk është krijuar, KLP thotë se duhet t'i drejtohen Kolegjit të Apelitit. Opozita pretendon se kryeprokuroria e përkohshme ka abuzuar me detyrën. Sipas opozitës, Arta Marku është e ngarkuar me detyrë nga ligji që të verifikojë integritetin e figurës për të gjithë ata që kandidojnë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por në rastin e Bujar Sheshi nuk e ka përmbyshur këtë detyrim ligjor. Bujar Sheshi rezultoi të ishte ish-anëtar i Sigurimit të Shtetit, me detyrë hetues. Ai vijon të jetë ende anëtar i KLP-së dhe ende nuk është marrë vendim për të.

Atentati, 29-vjeçari ndodhej pak metra larg makinës, kur autorët hapën zjarr KORÇË - Dy persona dyshohet se hapen zjarr mbremjen e së dielës, në drejtim të një automjeti të parkuar në qytetin e Korçës. Sipas TV "Klan", makina "Tuareg" ishte në pronësi të 29-vjeçarit Mateos Aliko dhe ky i fundit dyshohet se ishte objektivi i atentatit të dështuar. Autorët, ende të paidentifikuar qëlluan me breshëri automatiku në drejtim të makinës së 29-vjeçarit, ndërsa ai së bashku me një mikun e tij gjendeshin pak metra larg automjetit. Mateos Aliko nuk është emër i panjohur për autoritetet në Korçë. Ai mësohet se kishte pak muaj që kishte dalë nga burgu. 29-vjeçari ishte dënuar me 7 vjet heqje lirie për një grabitje me pasojë plagosjen, të ndodhur në një pikë bixhozi në rrugën Dishnicë-Korçë, në vitin 2008. Në lidhje me këtë ngjarje, policia ka shoqëruar disa persona.

Më 12 mars pritet që organi i akuzës të japë pretendencën për 47-vjeçar

Gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, "Eskobari i Ballkanit" përfiton uljen e 1/3 së dënimit

Prokuroria e Krimeve të Rënda: Ja provat që implikojnë Klement Balilin në trafikun e drogës

TIRANË

Gjykata për Krime të Rënda ka pranuar ditën e djeshme kërkesën për gjykim të shkurtuar për Kelmend Balilin, çka do të thotë që procesi për të cilësuarin si "Eskobari i Ballkanit", do të përmbyllet në vetëm pak seanca. Në vendimin e ndërmjetëm, gjykata arsyetoi se kërkesa nga i pandehuri është bërë brenda afateve ligjore dhe çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në këto kushte, nëse ish-drejtori i Transporteve në Sarandë shpallet fajtor nga drejtësia, ai përfiton menjëherë ulje të një të tretës së dënimit. Pas këtij vendimi, gjykata ftoi prokurorinë që të përgatisë konkluzionet përfundimtare. Në seancën gjyqësore më 12 mars, prokurori i çështjes Ened Nakuçi pritet të shpallë pretendencën dhe me gjasë të kërkojë dënimin e Balilit. Ish-zyrtari i lartë akuzohet për veprat penale: "Trafik të narkotikeve", "grup i strukturuar kriminal", "mosdeklarim të pasurisë" dhe "pastrim parash".

GJYQI

Seanca gjyqësore nisi me prokurorin Ened Nakuçi, i cili lexoi kërkesën për gjykim, ndërsa argumentoi ngritjen e katër akuzave për 47-vjeçar Balilin. Përfaqësuesi i organit të akuzës renditi një sërë provash ku sipas tij janë 20 CD me përgjime, hetimet e autoriteteve greke dhe DEA-s amerikane, sekuestro në flagrancë e 678 kg canabis në Greqi dhe arrestimi i dy shqiptarëve, të cilët drejtoheshin nga Balili. Si prova fajësie u renditen përgjimet telefonike të realizuara nga autoritetet greke në kuadër të një hetimi që po kryhej atje për një organizatë kriminale që trafikonte hashash e kokainë. Proku-

PRETENCA

Pas vendimit të marrë ditën e djeshme, Gjykata e Krimeve të Rënda ftoi prokurorinë që të përgatisë konkluzionet përfundimtare. Në seancën gjyqësore më 12 mars, prokurori i çështjes Ened Nakuçi pritet të shpallë pretendencën dhe me gjasë të kërkojë dënimin e Klement Balilit. 47-vjeçari akuzohet për 4 veprat penale dhe konkretisht: "Trafik të narkotikeve", "grup i strukturuar kriminal", "mosdeklarim të pasurisë" dhe "pastrim parash".



Klement Balili në sallën e gjyqit

rori Nakuçi deklaroi se gjatë hetimit nga homologët grekë është identifikuar një person me emrin Keli, që më vonë ka rezultuar se ishte Kelmend Balili. Ky i fundit sipas institucionit të akuzës, ka patur rolin e organizatorit në trafikimin e një sasive prej 678 kg drogë nga Shqipëria drejt Greqisë, atje ku edhe u arrestuan dy shtetas shqiptarë. Por këto prova, sipas mbrojtjes janë të pabazuara dhe nuk e lidhin Klement Balilin në asnjë çast me trafikun e narkotikëve. Në fund të seancës, trupa gjyqësore që për-

bëhej nga Flora Hajredinaj, Liliana Baku dhe Ardit Mustafai vendosën pranimin e kërkesës së Klement Balilit për gjykim të shkurtuar, ndërsa i lanë kohë prokurorisë dy javë me qëllim përgatitjen e pretendencës. Nëse procesi nuk do ketë vonesa të tjera, vendimi për Balilin pritet të merret brenda muajit mars, nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Në rast dënimi, ai përfiton uljen me një të tretën, pasi ka pranuar gjykimin e shkurtuar, të drejtë të cilën ia jep ligji. Klement Balili, një nga njerëzit

më të kërkuar në vend për trafik ndërkombëtar droge u vetëdorëzua në polici më 15 janar të këtij viti pas më shumë se dy vitesh në arrati. Në kërkesën për gjykim binte në

sy fakti, se Balili ishte kallëzuar nga ILDKPI për fshetje pasurie, disa muaj pasi ishte shpallur në kërkim. Kelmend Balili jetoi për dy vite në arrati për t'u vetëdorëzuar

VETËDORËZIMI

Ky proces gjyqësor pritet të jetë një nga më të shkurtit të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri. Gjithçka ka ndodhur në 40 ditë. Më 15 janar, Klemend Balili u vetëdorëzua pas negociatave të kryera me Policinë e Shtetit. Më 17 janar, ai doli për herë të parë në gjykatë për t'u njohur me masën e sigurisë dhe akuzat, duke i mohuar ato. Vetëdorëzimi i tij përkeoi edhe me dërgimin në gjykatë të dosjes nga ana e prokurorisë. Në 25 janar u zhvillua seanca paraprake ku Klement Balili kërkoi gjykimin e shkurtuar dhe gjykatësja e seancës paraprake e kaloi dosjen për gjykim, duke e konsideruar të mbyllur hetimin e prokurorisë.

vetëm disa javë më parë, kur dosja penale e tij u dërgua për gjykim. Ai mohon të jetë përfshirë në veprimtari kriminale dhe këmbëngul për pajafësi.

"Kjo është drejtësia e Edvinit, ta shporrim një minutë e më parë!"

Vendimi i Krimeve të Rënda, Berisha: Rama fali 'Eskobarin e Ballkanit', tani e ka radhën Aldo Bare

TIRANË - Vendimi i dhënë dje nga Gjykata e Krimeve të Rënda për pranimin e kërkesës së Klement Balilit për gjykim të shkurtuar ka pasuar me reagimin ish-kryeministri Sali Berisha. Në një status në "Facebook", Berisha thotë se Rama e fali për dënimin e rëndë që meritonte Eskobarin e Ballkanit duke renditur sipas tij dhe disa arsye. Ai shkruan më tej se radhën e gjyqimit të shkurtuar tani e ka Aldo Bare.

STATUSI I BERISHËS
Ediskobari fali Eskobarin! Të dashur miq, sot ashtu siç ishte njoftuar, premtuar dhe parashikuar, krye krye kreu Ediskobari fali për dënimin e rëndë që meritonte Eskobarin e Ballkanit, Klement Balilin. Shkaqet e faljes janë: Thesaret e Balilit, d.m.th. Videot me orgji të regjistruara në Santa Quaranta të vet Ediskobarit dhe narrojeritarëve të tij.



Ish-kryeministri Sali Berisha

Sjellja e mirë dy vite në arrati e Eskobarit çka detyroi Ediskobarin t'i njohë 1 vit arrati për tre vite burg dhe t'i rezervojë gjykimin e shkurtuar. Kjo e fundit u thotë gjithë kriminelëve qëndroni në arrati po dëshetë që

të keni lehtësi, natyrisht po patët video me orgji. Së fundi radhën e gjyqimit të shkurtuar e ka tani Aldo Bare. Miq, kjo është drejtësia e Edvinit, duhet ta shporrim një minutë e më parë! Revolucioni do të fitojë!

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: ITB for "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM & REHABILITATION OF ROADS IN ROMA QUARTER IN KULLE VILLAGE, DURRES MUNICIPALITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM & REHABILITATION OF ROADS IN ROMA QUARTER IN KULLE VILLAGE, DURRES MUNICIPALITY" to the address below.

For more details please refer to the link below:

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=53571

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 12 March 2019, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
Tirana, Albania
Fax.No: + (355) 4 225 02 86
E-mail: procurement.al@undp.org

"Zonat turistike, të destinuar për prodhimet e zejtarëve"

Klasi: Të mbjellim pemë frutore, bimë mjekësore që prodhojnë biznes dhe ekonomi

Gjatë vizitës 2-ditore në qarkun e Gjirokastrës, ministri Klasi zhvilloi një bashkëbisedim me prodhuesit e fabrikës së reçelit dhe glikove të famshme në Përmet "Pro Përmet". Me qëllim ju vetëm promovimin e produktit tipik lokal si markë tanimë edhe turistike, por edhe për t'i përfshirë ata në fushatën #krijoO2tend, një nga qëllimet e të cilës është mbjellja e pemëve frutore në ndi-

hmë të biznesit. Kjo është ajo që ministri Klasi u kërkoi sipërmarrësve të "Pro Përmet", mendime dhe ide për ta shëndëruar politikën për "Pyjet që Duam", në politikë që prodhon biznes dhe ekonomi. "Kemi edhe një diskutim shumë të gjerë tashmë për pemët medicinale, pemët e egra, mollën e egër, shegjen e egër, gështenjen e egër, për atë pemë unike që ka vendi ynë dhe që duke shtuar numrin e tyre, padyshim mund të shtojmë

shumë më tepër biznesin, me bimë. Ne jemi shumë të dëshiruar që të dëgjojmë edhe nga ju ide që kanë të bëjnë me këtë botën e pemëve. E dyta temë që donim të ndanim me ju është në dimensionin e turizmit. Ne e kemi kërkuar dhe sot në Shqipëri ka një ligj të zejes një ligj që kërkon që në zonat me përparësi zhvillimi turizmi, zonat që kanë intensitet prurjesh turistësh, zonat të cilat janë zona që janë karakteristike apo të

strukturuara dhe zona që jetojnë vetëm me turizmin dhe që padyshim Përmeti shënon një nga ato pikat kulturore të turizmit shqiptar, por nuk diskutohet që kalaja e Gjirokastrës apo zonat që kanë një theks të fortë turistik duhet të jenë të destinuar për prodhimet e zejtarëve shqiptarë", tha ministri Klasi. Ai u shpreh se nuk ka dyshim që reçeli i Përmetit apo glikoja e arrës janë prodhime të shquara të vendit tonë, por këto duhen mbrojtur dhe pro-



Ministri Blendi Klasi gjatë takimit në Përmet

movuar nga shoqata e zejtarëve, shoqata e atyre që prodhojnë mallra autentike shqiptare që të kenë ekskluzivitetin nëpër zonat turistike të vendit tonë.

"Po ushtrohet dhunë çdo ditë ndaj mjekëve. Jemi këtu për t'u ofruar shërbim qytetarëve"

Voltiza Duro

Mëngjesin e djeshëm, mjekët e urgjencës së Spitalit Rajonal në Durrës kanë protestuar kundër dhunës së ushtruar ndaj kolegut të tyre, Gerald Kola. Për 1 orë ata kanë pezulluar punën e tyre në shenjë solidariteti me mjekun e dhunuar si dhe kanë kërkuar fuqimisht masa më të forta sigurie në spitale, e veçanërisht në shërbimin e urgjencës. Madje, mjekët kanë kërkuar praninë e Policisë së Shtetit, në mënyrë që të shmangen situata të tilla dhune mes pacientëve e bluzave të bardha. "Jemi mbledhur sot këtu për t'u solidarizuar me kolegun tonë, i cili u dhunua në detyrë e sipër. Kërkojmë që të rriten masat e sigurisë në spitale, sidomos në shërbimin e urgjencës. Do të dëshironim gjithashtu që të ishte e pranishme Policia e Shtetit 24 orë, të paktën në shërbimin e urgjencës, në mënyrë që edhe ne ta kryejmë detyrën të qetë", - tha njëri prej mjekëve gjatë protestës. Një tjetër mjek, theksoi se janë në krye të detyrës për t'u shërbyer qytetarëve dhe jo për t'u dhunuar. "Ne kërkojmë që të kemi mbrojtje, të sigurohemi sepse po ushtrohet dhunë çdo ditë nga qytetarët kundrejt mjekëve. Mjeku është një aset dhe duhet mbrojtur. Ne jemi këtu për të ofruar shërbim dhe jo për t'u dhunuar", - theksoi një tjetër mjek për mediat gjatë protestës.

Mjekët e urgjencës në Durrës, në protestë: Dënojmë dhunën ndaj kolegut tonë

"Të rriten masat e sigurisë, të na mbrojë Policia e Shtetit"



Gjatë protestës së djeshme në spitalin rajonal të Durrësit



Mjeku i dhunuar, Gerald Kola

NGJARJA

Të shtunën, mjeku i urgjencës në Durrës, Gerald Kola u godit me mjete të forta në kokë, ndër të edhe një tullë, teksa përpiqej të ndante dy të dehur që po ziheshin në ambientet e Urgjencës.

Fillimisht mjeku roje ka ndërhyrë për të ndarë dy pacientë në gjendje të dehur dhe më pas është goditur me tullë. Kola, i sapo-emëruar në spitalin e Durrësit, pas incidentit të rëndë mori edhe ndihmën e parë, ndërkohë që policia nisi hetimet për rastin, duke shoqëruar edhe dy pacientët. "Më datë 23.02.2019, rreth orës 19:30, në Urgjencën e Spitalit Rajonal Durrës, kanë shkuar shtetasit E.Sh., 33 vjeç dhe M.B., 38 vjeç, banues në Durrës, në gjendje të dehur ku janë konfliktuar dhe dyshohet se kanë goditur


mjekun e Urgjencës. Shërbimet e Policisë kanë shkuar menjëherë në Urgjencën e Spitalit dhe shoqëruan në Komisarjat për veprime të mëtejshme dy shtetasit", - thuhet në njoftimin e policisë. **REAGIMI I MINISTRES** Pas ngjarjes së rëndë, ka ardhur dhe reagimi i ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila dënoi agresionin e ushtruar ndaj mjekut. Ajo më tej theksoi se për të ofruar një ambient sa më të sigurt për mjekët dhe për të shman-

gur incidentet e dhunshme, do të zbatohet urdhrin për regjimin e ri në spitale. Në këtë të fundit theksohet se në shërbimin e urgjencës (i cili është edhe më problematik për shkak të specifikave që mbart) nuk do të lejohen më familjarët e pacientëve, me përjashtim të rasteve kur kërkesa për praninë e tyre do të bëhet nga vetë mjeku. "Dënoj me forcë agresionin e dhunshëm ndaj mjekut në urgjencën e spitalit të Durrësit. Autorët e sulmit barbar të marrin dënimin maksimal që jep ligji. Të vendosur në zbatimin e urdhrin për regjimin

MANASTIRLIU

MASAT

"Dënoj me forcë agresionin e dhunshëm ndaj mjekut në urgjencën e spitalit të Durrësit. Autorët e sulmit barbar të marrin dënimin maksimal që jep ligji. Të vendosur në zbatimin e urdhrin për regjimin e ri në spitale. Asnjë familjar në shërbimin e urgjencës dhe respektim i orareve të vizitave në çdo spital!", - nënvizoi ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



e ri në spitale. ?Asnjë familjar në shërbimin e urgjencës dhe respektim i orareve të vizitave në çdo spital!?", - nënvizoi ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

SHPLLJE ANKANDI
 Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.03.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi II-të për shpjet e pasurisë së paluajtshme. Apartamenti me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çilrim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankand 22.727.61 (Njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

RAPORTET MJEKËSORE KUSHTET

Voltiza Duro

Të gjithë ata persona që kanë probleme shëndetësore e si pasojë nuk janë të aftë për punë, mund të përfitojnë raport mjekësor deri në 6 muaj. Në legjislacionin e Sigurimeve Shoqërore përcaktohen edhe kriteret mbi bazën e të cilave merret kjo pagesë nga raporti. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kushtet, afatet e përfitimit, dokumentacionin që duhet të dorëzojnë të interesuarit si dhe mënyrën se si përlogarit aritet masa e parave që do të marrin përfituesit.

KUSHTET

Sipas kushteve të përcaktuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në dy javët e para kjo pagesë e raportit mbulohet nga subjekti ku personi është i punësuar, ndërsa pagesat e periudhës së mbetur do të mbulohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Këto përfitime do të jenë të vlefshme vetëm kur komisionet mjekoligjore do të konfirmojnë nëpërmjet raportit përkatës paafhtësinë nga sëmundjet që mund të ketë punonjësi. "Pagesë për paafhtësi nga sëmundjet përfitojnë vetëm të punësuarit, ku 14 ditëshi i parë paguhet nga ana e subjektit ku punon përfituesi.

Ndërsa mbi ditën e 14-të të raporteve, të cilat jepen nga Komisioni Mjeko-Ligjor pagesat do të kryhen nga organet e sigurimeve shoqërore. Megjithatë, në çdo rast llogaritjet do të bëhen nga subjekti punëdhënës. Raporti mjekësor paguhet deri në 6 muaj gjithsej, duke përfshirë dhe pagesën prej 14 ditësh", theksohet në udhëzimin e ligjit të sigurimeve shoqërore.

PËRLOGARITJA

Përlogaritja e masës së pagesës së raporteve mjekësore përcaktohet nga mesatarja ditore e bazës së vlerësuar të vitit konkret në të cilin punonjësi kërkon marrjen e kësaj pagese. Një tjetër element nga i cili varet kjo masë e pagesës, është edhe vjetërsia e punës me kontribute që ka kryer individit. ISSH bën rastet kur punonjësi ka të evidentuar në librezën e punës më shumë se sa 10 vite, si vjetërsi kontributeve, masa e këtyre pagesave për raportet do të jetë sa 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar të vitit të fundit kalendarik kur para-

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë individët e interesuar

Raportet mjekësore/ Pagesë deri në 6 muaj, ja kush përfiton

ISSH: Sa para do të merrni për 14 ditë raport



qitet kërkesa e përfitimit", thotë ISSH.

DOKUMENTACIONI

Për të përfituar pagesën nga raportet mjekësore, personi i interesuar duhet të dorëzojë pranë subjektit ku punon dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin e sigurimeve shoqërore.

"I punësuar duhet të dorëzojë pranë subjektit ku punon këto dokumente: Fotokopje e Kartës së identitetit; Librezën e punës/Vërtetim vjetërsie; Formularin e bazës së vlerësuar të 6 muajve të fundit (ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit ose printohet nga sistemi <https://e-albania.al/>). Ndërkohë, sektori i financës së subjektit punëdhënës, mbështetur në dokumentet e dorëzuara duhet që të plotësojë formularin tip-listëpagesë të përfitimeve afatshkurtra, të cilën më pas duhet ta dërgojë pranë ALSSH-së, ku ka aktivitetin subjekti. Më tej ALSSH pasi kontrollon dhe verifikon dokumentat e sjella, i kalon pagesat në logarinë personale të përfituesit. Gjithashtu agjencia kryen verifikimet përkatëse në lidhje me vlefshmërinë e dokumenteve të paraqitura në dosjen e secilit aplikues aprovon, ose jo ndarjen e pagesës së raporteve mjekësore për paafhtësi nga sëmundjet. Në

rastet kur dokumentet janë të rregullta, agjencia rajonale e sigurimeve shoqërore i kalon pagesat në logarinë personale të përfituesit, ose në logarinë e subjektit.

PAAFËTËSIA E PËRKOHSHME

E ardhura për paafhtësi të përkohshme, si pasojë e një aksidenti në punë, ose sëmundjeje profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë, do të jetë e barabartë me 100 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës. Ndryshe nga sa ndodh me pagesat e raporteve, në ligjin e ndryshuar të sigurimeve shoqërore bëhet me dije se e ardhura për paafhtësi të përkohshme, lëshohet për një periudhë përfitimi deri në 12 muaj. Punonjësi i siguruar që për shkak të aksidentit në punë, ose sëmundjes profesionale humbet aftësinë për punë ka të drejtë që të aplikojë për përfitimin e të ardhurave të caktuara nga organet e sigurimeve shoqërore. Sipas autoriteteve të ISSH-së, ky punonjës ka të drejtë: "Të sigurojë të ardhura për paafhtësi të përkohshme nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale, të ardhura për invaliditet të përhershëm nga

aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale, të ardhura për invaliditet të pjesshëm dhe të përhershëm të shkaktuar nga aksidenti apo sëmundja profesionale, si dhe të ardhura për paafhtësi të përhershme në masë të vogël".

AFATET

Masa e përfitimit ligjorohet në rast të vlefshmërisë së raportit të lëshuar nga spitali, apo komisioni mjeko ligjor. Përfitimi i këtyre të ardhurave lejohet deri në 12 muaj. Ndërsa masa e përfitimit do të jetë sa 100 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit kalendarike. Kjo masë do mbetet e tillë deri në përfundim të muajit të dymbëdhjetë. Dokumentet që duhet të dorëzohen për këto të ardhura, janë të njëjta me ato të listuara në rastet pagesave për raportet mjekësore të paafhtësisë nga sëmundjet që mund të ketë punonjësi i siguruar deri në 10 vite, apo edhe mbi këtë periudhë.

GRUPET E INVALIDITETIT

Në vartësi të shkallës së humbjes të aftësisë për punë, sipas ndryshimeve të bëra në ligjin e sigurimeve shoqërore, invaliditeti klasifikohet në tri grupe. Grupi i parë përfshin individët me invaliditet të pjesshëm, kur personi i siguruar humbet aftësinë për punë në profe-

sonin apo punën e tij të fundit, por mund të kryejë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAP-it. Në grupin e dytë janë pagesat për invaliditet të plotë, në rastet kur personi ka humbur tërësisht aftësinë për të kryer çdo lloj pune të mundshme. Ndërsa në grupin e tretë janë invaliditeti i plotë në kushtet e nevojës për kujdestari. Tre rastet e përfitimeve të pagesave të invaliditetit

Sipas përcaktimeve të bëra nga organet e sigurimeve shoqërore mbi kushtet e përfitimit të këtyre pagesave të invaliditetit, duhet që periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti të jetë sa 3/4 e diferencës së moshës së personit

të siguruar në kohën që bëhet i paafhtë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Ndërsa personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

Gjithashtu, pohohet se personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.

KRITERET DHE DOKUMENTET

Kushtet e përfitimit:
Pagesë për paafhtësi nga sëmundjet përfitojnë vetëm të punësuarit;

► 14 ditëshi i parë paguhet nga ana e subjektit ku punon përfituesi;

► Mbi ditën e 14-të të raporteve, të cilat jepen nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KM), raportet paguhen nga sigurimet shoqërore. Por gjithmonë llogaritjet bëhen nga subjekti;

► Raporti mjekësor paguhet deri në 6 muaj gjithsej, duke përfshirë dhe pagesën prej 14 ditësh.

Masa e përfitimit:

► Të ardhurat për sëmundje janë 70 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim;

80 për qind kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim.

Dokumentacioni:

I punësuar duhet të dorëzojë pranë subjektit ku punon këto dokumente:

- Raportet mjekësore;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Librezën e punës/Vërtetim vjetërsie;
- Formularin e bazës së vlerësuar të 6 muajve të fundit. (Ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit ose printohet nga sistemi <https://e-albania.al/>);
- Sektori i financës së subjektit, mbështetur në dokumentet e pikës "a", plotëson formularin tip-Listëpagesë e përfitimeve afatshkurtra, dhe e dërgon atë në ALSSH-në, ku ka aktivitetin subjekti;
- ALSSH pasi kontrollon dhe verifikon dokumentet e sjella, i kalon pagesat në logarinë personale të përfituesit.

Rrëfëhet këngëtarja: Muzika dhe jeta ime përtej skenës, ja si i marr gjërat

Silva Dollapi:

Disa këngë e këngëtarë vijnë e ikin si kërpudhat pas shiut

"Ne investojmë për t'u bërë të famshëm e pastaj mërzitemi"

Egla Xhemali

Është më e kërkuara në mbremjet live që organizohen kudo në diasporë. Silva Dollapi, një ndër zërat më të bukur dhe më të dashur të trevave të veriut, sjell klipin e saj më të ri 'Hajde hopa-hopa' një bashkëpunim me muzikantin e talentuar Mikel Osmani. Këngëtarja ruan formën dhe bukurinë e rinisë së hershme, tashmë nënë e një vajze dhe me jetë koncertore të ngjeshur. Për "Gazeta shqiptare" Silva vjen në një rrëfim për jetën e saj mes muzikës dhe përtej shkëlqimit të skenës. Ajo na tregon edhe për shumëllojshmërinë që ka tregu muzikor në Shqipëri duke theksuar se këngët e mira i mbijetojnë kohës.

Këtë herë na vjen me një klip të ri, na trego pak më shumë?

Përsëritet dhe respekt! Sapo ka dalë në treg kënga dhe klipi më i ri 'Hajde hopa hopa'. Është pritur shumë mirë nga publiku. Kënga është punuar në studion e "Xoxo", me të cilin bashkëpunoj prej disa vitesh dhe video e realizuar nga Dart Channel.

Bashkëpunimet janë në trend tani. Shumica e tyre rezultojnë hite. Pse e bëtë ju këtë zgjedhje?

Këngët duet janë gjithnjë të bukura, sidomos mashkull-femër kanë më larmishmëri dhe janë më të kapshme për audiencën.

Çfarë vlerëson më shumë në jetë?

Në jetë vlerësoj familjen, shëndetin dhe gjithçka tjetër të mirë që ka të bëjë me mua.

Sa e vështirë është të jesh një këngëtarë e suksesshme në këtë larmi që ofron tregu i muzikës shqiptare?

Të jesh e talentuar në këtë kohë është të mbijetosh, por gjithmonë këngët e bukura dhe muzika e mirë fitojnë vëmendjen e publikut. Disa këngë e këngëtarë vijnë e ikin si kërpudhat pas shiut, ndërsa krijimet e mira bëhen hite.

Të jesh personazh publik, ka më shumë anë pozitive



sesa negative?

Të jesh person publik është bukur, ne investojmë për t'u bërë të tillë e pastaj mërzitemi. Është shumë bukur dhe privilegj mendoj unë. Kështu e shoh, më vjen mirë kur njerëzit më admirojnë e më thonë 'Krenaria e malësisë', shpresoj ta meritoj.

Si do të doje të identifikoj

hej imazhi yt si këngëtarë?

Mendoj që kam krijuar imazhin tim, këndohen këngët e mia, më adhurojnë zërin, repertorin, veshjet e lukun. Më pëlqen kur thonë: 'Si Silva'

Mendon se një fytyrë e bukur fsheh edhe një shpirt të bukur?

Do të thosha një

buzëqeshje e bukur fsheh një shpirt të bukur. Mënyra si buzëqesh, si flet, si rri, si sillesh. Këto pasqyrojnë shpirtin, jo fytyra.

E ke të rëndësishme të jesh "IN" me tendencat e fundit?

Më pëlqen të eci me kohën, jam e fiksuar pas pamjes së jashtme: grimi,



flokët, veshjet dua të jenë perfekte.

Sa natyrë ekspresive e konsideron veten?

Jam shumë e qetë, nervat i ledhatoj.(qesh) Shquhem për qetësi, i marr gjërat me sportivitet dhe më del më mirë. Para një muaji më iku avioni, duke qeshur mora linjën tjetër dhe prita

katër orë. Ja pra çdo gjë u rregullua, me qetësi, dashuri dhe ëmbëlsi. Jeta vazhdon.

Të qenit i pëlqyer e bën më të bukur ekzistencën e një artisti?

Të jesh i pëlqyer ke arritur atë që do. Në fund të fundit jetojmë që të pëlqehemi.



20 vjet SIGAL UNIQA Group Austria, inauguron veprën "MIRENJOHJE-FALENDERIME TE GJITHEVE" në qendër të Tiranës



Në inaugurimin e veprës në qendër të Tiranës z. Ponari shprehu mirënjohjen dhe falënderimet për të gjithë ata që i besuan që nga fillimi dhe të gjithë të tjerë që iu bashkuan rrugës.



SIGAL UNIQA, që prej 20 vitesh, me punën e saj të përditshme kërkon të frymëzojë, të jetë vazhdimisht në zhvillim, të servirojë vlera dhe jo vetëm produkte.

Përmasat që SIGAL UNIQA ka marrë përgjatë viteve i kalojnë kufijtë e Shqipërisë dhe është shndërruar në një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve, ku rreth 1200 punonjës u shërbejnë mbi 1 milionë klientëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

SIGAL UNIQA, që prej vitit 2002 renditet e para në tregun e sigurimeve me mbi 65 milionë euro prime në vit dhe rreth 300 milionë euro dëme të paguara ndër vite dhe 121.100.000 Euro ASETE.

Që prej vitit 2007, SIGAL UNIQA është pjesë e gjigandit austriak të sigurimeve UNIQA Group Austria, me një histori 200-vjeçarë në tregun evropian të sigurimeve, i cili numëron 7 miliardë euro prime në vit dhe zotëron 33 miliardë euro asete.

Të dhëna mbi SIGAL UNIQA Group Austria:

- Grup rajonal me 8-të Kompani Sigurimi, Risigurimi dhe Fond Pensioni Privat
- 3 shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni
- Kompania e parë që futi investimet e huaja në kompani: Fondi Shqiptaro-Amerikan u bë pjesë e SIGAL në vitin 2003 dhe më pas në 2007-ën UNIQA Group Austria.
- Që prej 2002 udhëheq tregun shqiptar me 30%
 - mbi €65 milionë Prime/vit
 - € 121.1 milionë Asete
 - 300 milionë Euro dëme të paguara ndër vite
 - 1.000.000 klientë (AL KS MK)
 - 1 200 punonjës dhe agjentë
 - Mbi 900 zyra në 3 shtete
 - Të parët në blerjen online të siguracioneve
 - E vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimit
 - Të parët në sigurimet e Jetës, Jo-jetës dhe Pensioneve



Fjala e plotë e Avni Ponarit, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

*I nderuar Kryetar i Këshillit Bashkisë Tiranë zoti Dalipi,
Të nderuar klientë, partnerë, staf
Të nderuar pjesëmarrës*

Në kuadër të 20-vjetorit të SIGAL UNIQA Group Austria, inaugurojmë sot veprën, të cilën e kemi titulluar: "MIRENJOHJE-FALENDERIME PER TE GJITHEVE".

Por pse ky motiv?

Sepse sot më shumë se kurrë ne kemi nevojë të themi FALEMINDERIT!
Sepse sot ne kemi nevojë të jemi MIRENJOHËS dhe të jemi gjithë jetën të tillë;
Sepse sot ne duhet të kthejmë kokën pas e të kujtojmë fillimet tona dhe këtë ta bëjmë gjithmonë;
Sepse sot ne duhet të jemi edhe më humanë se kurrë më parë; Sepse të tillë duhet të jemi çdo ditë;
Sepse ky qytet ka nevojë për mirënjohje ka nevojë për falënderime ka nevojë çdo ditë e në çdo pjesë të tij.

Mirëkuptimi, respekti, mirënjohja dhe vlersimi i bërë ndaj gjithkujt në këtë jetë, tingëllon më bindës kur ai shndërrohet në njëkohësisht edhe në një detyrim moral, për të vijuar udhën e nisur.

Sepse nëse jemi mirënjohës, jemi më të njerëzishëm, jemi më të arsyeshëm, jemi më bashkëkohorë, jemi qytetarë evropianë.

Sot ne SIGAL kemi nevojë të falënderojmë, të shprehim mirënjohjen të gjithë atyre që kanë qëndruar përkrah që nga fillimi i rrugëtimit tonë, në një det të trazuar, plot dallëje që ka kërkuar kapiten dhe ekipazh të zot dhe deri sot, ku themi me krenari që jemi një kompani me standarte evropiane sepse kemi ditur të shkojmë në destinacion.

Por mbi të gjitha sot ne jemi një kompani e madhe në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërbejmë atyre me të cilët ne shkëmbejmë në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirënjohjes, atyre me të cilët ndajmë qytetet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme.

Të jesh mirënjohës është një element njerëzor, një virtut që padyshim shqiptarët e kanë patur gjithmonë dhe do e kenë edhe në të ardhmen.

Prandaj dhe këtë veprë e kemi titulluar MIRENJOHJE.

Çdo ditë ne punojmë, rritemi, ecim përpara, rritet biznesi, zgjerohen partnerët, stafi, miqësia, familja, shoqëria, rritet dhe zhvillohet edhe qyteti ku jetojmë dhe vjen një moment kur duhet të ndalemi, të reflektojmë dhe të jemi mirënjohës për çdo gjë që kemi arritur deri më tani dhe tu themi FALEMINDERIT të gjithë atyre që na rrethojnë dhe që kanë kontribuar në zhvillimin tonë të përbashkët.

Mirënjohja dhe falënderimi duhet jo vetëm të thuhet me fjalë por edhe të shprehet me vepra. Dhe këtë ne nuk e bëjmë vetëm sot, por e kemi bërë që nga fillimi i aktivitetit tonë. Dhe

nuk e kemi bërë vetëm me fjalë, por mbi të gjitha kemi folur me vepra, duke mbajtur fjalën e dhënë dhe besimin të çdo punonjësi i SIGAL, tek çdo klient i ynë, duke mbajtur premtimin dhe duke u përpjekur çdo ditë për të bërë një shërbim më të mirë, më cilësor. Në 20 vite ne kemi paguar mbi 300 milionë euro dëme, duke qenë kontribues të heshtur por fjalë-mbajtës e për këtë jemi mirënjohës e u themi të gjithëve faleminderit.

SIGAL që nga krijimi i tij, që prej 1999, ka kontribuar në art, kulturë, trashëgimi kombëtare, në të gjitha disiplinat e sportit, në promovimin e Shqipërisë, në zhvillimin social dhe ekonomik jo vetëm të Tiranës, por pothuaj në të gjitha qytetet e Shqipërisë, ne kemi realizuar vepra të cilat u shërbejnë qytetarëve, ne kemi ngritur peshë zemrat e mijëra qytetarëve shqiptarë në veprimtaritë e mbështetura nga ne, brenda e jashtë kontinentit sepse ne kemi qenë gjithmonë pranë të gjithëve nga pak, por gjithmonë mirënjohës ndaj secilit...

Sepse ne besojmë që një biznes të ketë sukses duhet që të kemi edhe një shoqëri të sukseshme, dhe një qytet të sukseshëm dhe një vend në progres ekonomik.

Ne, dhjetë vjet më parë u bëmë pjesë e Europës, pjesë e një kompanie Austriake dhe prej 10 vitesh ne punojmë me standarte Evropiane.

Ne nisëm një rrugëtim me pak veta, por rreth nësh na u bashkuan shumë veta mbi 1500 punonjës e mbi 1 milion klientë. Prandaj dhe sot është momenti që të ndalemi, të kthejmë kokën pas dhe të kujtojmë të gjithë ata që ishin me ne që nga fillimi por edhe ata që na u bashkuan rrugës, sepse secili prej tyre ka dhënë një kontribut të veçantë dhe të paçmueshëm për SIGAL-in në radhë të parë por edhe për zhvillimin dhe progresin individual të tyrin por edhe dhe të të gjithë shoqërisë shqiptare.

Sot unë ju them me zemër FALEMINDERIT dhe MIRENJOHJE të gjithë atyre që na besuan e do na besojnë, ata janë busulla jonë e orientimit.

Ndaj kjo veprë në qendër të Tiranës po ngrihet sot për të gjithë rrugëtimin 20-vjeçar e për qindra vite të tjera në rrugëtimin tonë të gjatë.

Sot u themi FALEMINDERIT stafit të shkëlqyer të SIGAL që u shërben klientëve me përkushtim dhe profesionalizëm, bordit drejtues dhe bashkëpunëtorëve të cilët besuan tek ne 20 vite më parë themelimin e kësaj kompanie, Fondit Amerikan që pati besimin e ju bashkua që nga viti 2003 kësaj kompanie, UNIQA Group Austria, kompania 120 vjeçare që është tashmë prezente në rrugëtimin e gjatë për të kapur destinacione të reja.

FALEMINDERIT dhe MIRENJOHJE çdokujt që ka qenë pjesë e këtij rrugëtimit dhe pjesë e jetës tonë të përditshme. Edhe njëherë Faleminderit dhe Mirënjohje të gjithëve.

AVNI PONARI
CEO
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
SHQIPËRI-KOSOVË-MAQEDONI

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e PAGESAVE nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, goftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
Mrke	Perlesi	Lize	Ndreu	V	V				ZV	
		Ndue	Perlesi	V	V					
		Dave	Lleshi	V	V					
		Zef	Perlesi	V	V					
		Mark	Gjoni	V	V					
		Preng	Perlesi	V	V					
		Tereze	Lleshi	V	V					
		Marjçe	Perlesi	V	V					
		Llesh	Perlesi	V	V					
		Gjergj	Perlesi	V	V					
		Bardhok	Perlesi	V	V					
Dava	Tusha			V	V					
Gjergj	Coli								ZV	
		Nkoll	Coli	X	V					
		Zef	Coli	X	X					
		Fran	Coli	X	X					
		Gjovall	Coli	X	X					
		Drande	Prenga	X	X					
Gjon	Coli			V	V					
Tereze	Mhalli			V	V					
Lize	Markolaj					V			ZV	
		Pashk	Markolaj	V						P
		Gjin	Markolaj	X	X					
		Vitore	Kovaçi	X	V					
		Gjovall	Markolaj	X	V					
		Bardhok	Markolaj	X	X					
		Sokol	Markolaj	V						P
Drande	Lleshgëgjaj			V	V					
Prene	Malaj			V	V					
		Mark	Markolaj	V	V				V	
						V	V	V	ZV	
Sabije	Mehja					V	V	V		
		Besnik	Mehja	X	X					
		Fic	Mehja	X	X					
		Nure	Mehja	X	X					
		Gjylë	Hasa	V						P
		Qerim	Mehja	V						P
		Nazë	Lala	V						P
		Bujar	Mehja	V						P
		Peperim	Mehja	X	X		V	V	ZV	
Shaze	Vogël									
		Petrit	Vogël							
		Hatije	Sma	V						P
		Ismete	Dedja	V						P
		Bajram	Vogël	V	V					V
		Ali	Vogël	V						P
		Minashe	Vogël	X	X					
		Myslym	Vogël	X	X					
		Nazime	Bha	V						P
Demir	Matera					V			ZV	
		Sheqere	Lala	V						P
		Ruzhdi	Matera	V						P
		Nuredin	Matera	X	X					
Hike	Hasku					V	V	ZV		
		Agim	Hasku	V						P
		Hamit	Hasku	X	X					
		Hatirçe	Hasku	X	X					
Teha	Matera					V		ZV		
		Myzejen	Rrogozhina	V						P
		Aslan	Matera	V						P
		Elera	Matera	X	X					
		Peperim	Matera	X	X					
						V	V	V		
Llesh	Deda					V	V	ZV		
		Dave	Kuçaj	V						P
		Ndue	Deda			V	V	V		
		Gjon	Deda			V	V	V		
		Drane	Deda	V						P
		Jani (Bardhok)	arku (Deda) 27/01/19	V						P
		Dile	Lleshaj	V						P
		Marjana	Pahka							

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
		Kol	Cupi	V						P2
		Marjana	Tuci	V	V					V2
		Agim	Cupi	V						P2
		Vjollca	Deda	X	X					
		Gezame	Mikic	V						P2
Liza	Gjergjaj					V			V	
		Donika	Bardhi	V	V					
		Dile	Gjoni	V	V					
		Vjollca	Gjalevska							P1
		Gezim	Gjergjaj	V	V					
		Dave	Gjergjaj	V						P1
		Parind	Gjergjaj	V	V					
		Roza	Gjergjaj							P1
		Ardit	Deda	V	V					V
		Mark	Gjergjaj	V	V					V1
						V	V	V		
						V	V	V		
ESMA	MEBELLI					V	V	V		
FERIT	MEBELLI					V	V	V		
		HYRIETE		V	V					
		GANIMETE				V				
PETREF	MEBELLI	SHERJANE				V	V	V		
		FERIT		V	V					
ENISE	MEBELLI					V	V	V		
		XHAFERR		V						P2
		LADIMIR		V						P2
		LUAN		V	V					V2
		BALLKEZE		V						P
		EDMOND		V						P2
		LILJANA		V						P
		LUIZA		V						P2
NAMIK	MEBELLI					V	V	V		
		TATJANA		V						P1
		LAVDIJE		V	V					V1
		MYNYRE		V						P1
		BILBIL		V						P1
		PERRI		V						P1
NURIE	CEKA			V						P
BUKUROSHIE	XHIANI			V						P
DVILFROARE	HALLILAJ			V						P
FLORESHIE	SHEMAJ			V						P
GELARDINA	SPAHIU			V	V					V
RESHAT	MEBELLI					V	V	V		V
		KUDRET (THOMA)		V	V					V3
		SHKELQIM		V						P3
		SADIK				V		V		
		PELLUMB		V						P3
		VASIL		V						P3
		MAKSIM		V						P3
		JOLANDA		V						P3
		MARIE		V						P3
KRISTIN	KUSHI			V	V			V	V	
SOKRAT	KUSHI			V	V					
YLLI	KUSHI					V	V			P
GENCI	KUSHI					V	V			V
ELIDA	TODRI					V	V			
FIRUZE	PASHO					V	V	V	V	
MALKO	PASHO					V	V	V	V	
		MALKO		V	V					
		MALKO		V	V					
VESEL	PASHO			V	V					
FATMIR	PASHA			V	V					
AFROVITI	SKAPETA			V	V			V	V	V
THEONI	ZERI			V	V			V	V	X
AMALLA	XHUMBA			V	V					
NIKOLLA	PAGUNI			V	V					
THOMA	PAGUNI					V	V	V	V	
		THOMA		V	V					

Mosheqja e taksës, Aleksandar Vuçiç nuk pranon dialog

Deklaratat e ministrit gjerman për mbështetje, Haradinaj: Vendimtare për vizat

Aleksandar Vuçiç, presi dienti i Serbisë s'ka ndër mend t'i vazhdojë bisedimet në Bruksel pa u hequr taksa e vendosur nga qeveria e Kosovës ndaj mallrave të Serbisë që importon Kosova. Sipas mediave serbe, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç "është shfaqur i tërhequr për shkak të qëndrimit të Prishtinës, e cila pavarësisht presionit të bashkësisë ndërkombëtare nuk po i heq taksat ndaj mallrave serbe". Vuçiç ka konstatuar se BE nuk po mundet dot t'i bëjë presion autoriteteve në Prishtinë. Shefi i shtetit serb këto ko-



ALEKSANDAR VUČIČ

"Jam shfaqur i tërhequr për shkak të qëndrimit të Prishtinës, e cila pavarësisht presionit të bashkësisë ndërkombëtare nuk po i heq taksat ndaj mallrave serbe", - ka thënë Vuçiç.

mente i ka bërë pas takimit me ambasadorin e Italisë në Beograd Carlo Lo Cascio ku ka thënë se Serbia do t'i kthehet dialogut pasi të hiqet taksa. Nga ana tjetër, pas deklaratave

të ministrit të Jashtëm të Gjermanisë, Heiko Maas ka reaguar edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Përmes një postimi në "Facebook", Haradinaj shprehet se deklaratat e ministrit të Jashtëm gjerman për "Stuttgarter Nachrichten" tregojnë mbështetjen që vjen nga Gjermania për Kosovën. Kreu i qeverisë së Kosovës shprehet se mbështetja e Gjermanisë ndaj Kosovës është vendimtare për procesin e liberalizimit të vizave.

Postimi i plotë i Haradinajt: Të dashur qytetarë. Jam i lumtur të ndaj me ju deklaratën mbështetëse që vjen nga Gjermania mike, për reformat e ndërmarr

shetërore. Në intervistën e dhënë për gazetën gjermane "Stuttgarter Nachrichten", kushtuar Kosovës, ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas e ka vlerësuar lartë angazhimin e qeverisë së vendit tonë duke thënë se "Reformat të cilat janë kryer atje janë mbështetëse dhe kjo duhet të pranohet". Ky është edhe një rikonfirmim se mbështetja e përzërvë e Gjermanisë për Kosovën është rezultat i partneritetit të ngushtë e të sinqertë me shtetin gjerman, si dhe është vendimtar për procesin e liberalizimit të vizave dhe rrugën evropiane të Kosovës.

Serbia kërkon marrëveshje me Kosovën para zgjedhjeve në SHBA

Franca kërkon heqjen e taksës, Haradinaj s'ndryshon vendim

Largimi i Trump, Daçiç: Do të ketë një ultimatum

Vijojnë reagimet e ndërkombëtarëve lidhur me taksën e vendosur nga Kosova ndaj Serbisë për mallrat. Ka qenë ambasada e Francës në Prishtinë, e cila përmes një përgjigjeje të dhënë gazetës "Zëri" ka thënë ditën e djeshme se taksa 100 për qind, e vendosur para më shumë se tre muajsh ndaj produkteve serbe, duhet të pezullohet ose të hiqet. Por pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të ndërkombëtarëve për pezullimin e taksës, kryeministri Ramush Haradinaj po vazhdon të zotohet se taksa nuk hiqet pa pasur paraprakisht një marrëveshje për njohje të Kosovës nga Serbia. Vendimi i qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës ndaj produkteve që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina ka nxitur reagime të shumështeteve të fuqishme të botës, të cilat po vazhdojnë të kërkojnë heqjen ose pezullimin e kësaj tarife. Një gjë të tillë tashmë e ka kërkuar edhe Franca. Zyrtarë të ambasadës së Francës në Kosovë shprehen se qëndrimi i tyre rreth kësaj çështjeje është më se i qartë, që masa ndaj produkteve serbe dhe atyre boshnjake duhet të pezullohet ose të hiqet. Ndërkohë, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mënyrë të parështur janë duke kërkuar pezullimin e tarifës prej 100 përqind. Si pasojë e barrikadimit të qeverisë kundër heqjes së taksës SHBA-ja madje ka nisur edhe vendosjen e sanksioneve ndaj Kosovës. Nga deklaratat e bëra Amerika është e përfshirë në mënyrë aktive në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Administrata e tyre po i bën presion Prishtinës që të tërhequr tak-



sën mbi mallrat nga Serbia në mënyrë që të dyja palët pas disa muajsh të vakumit përsëri të ulen në tryezën e bisedimeve. Vetë Trumpi i dërgoi një letër presidentëve Aleksandar Vuçiç dhe Hashim Thaçi, me të cilin iu apelon atyre për të bërë gjithçka, për shkak se ata kurrë nuk kanë qenë më afër marrëveshjes historike sesa tani. Megjithatë ende nuk dihet se kush mund të dalë kundër linjës së Trumpit, ndryshimi i administratës dhe ardhja e demokratëve do të ndikonte, gjithashtu, në ngjarjet në këtë rajon. Ministri i jashtëm serb Ivica Daçiç ka vlerësuar në një deklaratë për "Blic" se largimi i Trumpit do të ishte një gjë e keqe për zgjidhjen e problemit të Kosovës. "Kjo nuk na përshatet. Do të ketë një ultimatum - gjithçka tashmë është zgjidhur, Kosova tashmë është e pavarur dhe ne duhet vetëm që ta njohim" - thotë Daçiç. Dragan Gju-

kanoviç nga Qendra për Politikë të Jashtëm beson se administrata e re do të mbetet në të njëjtin rrugë kur është fjala për adresimin e kësaj çështjeje. "Administrata e re do të kishte të njëjtën qasje vendimtare në këtë çështje. Për më tepër, presioni për t'i dhënë fund dialogut do të ishte sigurisht dhe më i fuqishëm. Përveç kësaj, ndikimi amerikan do të ishte pa dyshim më i fortë në lidhje me anën e Kosovës dhe korniza për zgjidhjen përfundimtare do të kishte qenë shumë më e përafërt me atë që e kërkon Prishtina" - tha Gjykanoviç. Zgjedhjet në Shtetet e Bashkuara duhet të mbahen në vjeshën e vitit të ardhshëm, dhe ai që vjen në zyrën e Presidentit ose ndoshta zëvendëson Trumpin, merr detyrën më 1 janar 2021. Marko Savkoviç nga Fondi për Përparesi Politike të Beogradit thekson se ende mbetet pak kohë për të arritur një zgjidhje përfun-

dimitare kur kemi të bëjmë me Kosovën. "Ajo që bëhet në gjysmën e parë të vitit 2020, është bërë. Pas kësaj, rregulli është të mos bëhen gjëra të mëdha, përndryshe do të ishte në kundërshtim me praktikën" - tha Savkoviç duke deklaruar se për Serbinë do të ishte negative ndonjë vonesë e mëtejshme në zgjidhjen e problemit. Ai thotë se rezultati i zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara vërtetë të parashikohet, sepse nuk është ende e qartë se kush do të jetë sfidues i Trumpit, si dhe vet Trump ka gjasa të mëdha për një mandat të ri. I pyetur nëse një marrëveshje e mundshme do të ishte e rëndësishme për Trumpin në planin e brendshëm, Savkoviç u përgjigj në mënyrë pozitive. "Të gjithë presidentët e SHBA-së kanë momentet e tyre të shkëlqyera. Bill Clinton, për shembull, kishte momentin e tij me Peresin dhe Arafatin. Është gjithmonë e rëndësishme të paraqiteni si një paqebërës i madh dhe të dërgoni një mesazh. Nuk është e vërtetë se ai nuk është i interesuar për ngjarjet në botë", përfundon Savkoviç. Zgjedhjet amerikane nuk janë të vetmet që mund të ndikojnë në ngjarjet rreth Kosovës. Në pranverë do të mbahen zgjedhjet e Parlamentit Evropian pas së cilave do të ndryshojë përbërja e Komisionit Evropian, dhe një komisioner do të jetë nga mjedis i kryeministrit hungarez Viktor Orban, zëvendës kryeministrit italian Matea Salvini dhe atij polak, Jaroslav Kaczyński. Orban dhe Salvini kanë lidhje të ngushta me Putinin. Komisioni i ri Evropian do të forcojë rolin e Putinit në Ballkan dhe zgjidhja mund të duket e largët.

SHKURT

Federata Spanjolle e Futbollit nuk pranon simbolet e Kosovës

Federata Spanjolle e Futbollit nuk ka pranuar ditën e djeshme që Përfaqësuesja e Kosovës të zhvillojë ndeshjet e grupit të pestë për kampionatin evropian U-17 "Irlanda 2019" me simbole shtetërore. Ajo kërkoj nga Federata e Futbollit të Kosovës që të mos prezantohet me simbole shtetërore duke kërkuar kështu gjetjen e një zgjidhjeje alternative apo përdorimin e flamurit të UEFA-s. Sekretari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu tha për Radio Evropa e Lirë se pas ankesës së FFK-së në UEFA është vendosur që ndeshjet të zhvillohen në shtetin e Zvicrës. "Ne kemi shkruar letër dhe kemi thënë se në asnjë rast ne nuk pranojmë me marrë pjesë në asnjë garë të UEFA-s në të cilën nuk shpalolet flamuri edhe himni i Kosovës. Ata kanë thënë se a bën me logo të federatës?! Ne u kemi thënë se asnjë lloj kompromisi nuk bëjmë vetëm kërkojmë të luajmë futboll", tha Salihu. Federata e Futbollit të Kosovës bëri të ditur se ka kërkuar masa ndëshkimore ndaj shteteve të cilat për arsye politike pengojnë apo nuk mund të organizojnë ndeshje të futbollit. "Kemi kërkuar nga UEFA që të ketë pasoja për shtetet që nuk janë të gatshme të organizojnë, kanë probleme, konteste. Kështu që është një mësim i mirë për Spanjën, për të keq, kuptohet", deklaroi Salihu. Sekretari i FFK-së, Eroll Salihu, tha se UEFA ka pasur qëndrim korrekt për sa i takon këtij rasti. "Tregues i kësaj është vet fakti pse Spanjës i është marrë e drejta e organizimit të këtyre ndeshjeve", tha Salihu. Në kuadër të kampionatit U-17 "Irlanda 2019", Kosova do të përballlet edhe me dy shtete që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, duke përfshirë, Greqinë dhe Ukrainën. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen prej 25 deri më 31 mars të këtij viti. Edhe më herët shteti spanjoll ka penguar sportistët nga Kosova. Kampionati Evropian për Junior në Peshëngritje u zhvillua në Poloni ani pse fillimisht kjo e drejtë i ishte dhënë Spanjës. Asaj iu hoq e drejta pasi nuk lejoi pjesëmarrjen e peshëngritësve kosovarë me simbole të Kosovës.

Mal i Zi, protestuesit kërkojnë fundin e regjimit 30-vjeçar të presidentit

Më shumë se 10 mijë protestues marshuan të dielën në Podgoricë të Malit të Zi duke kërkuar fundin e udhëheqjes 30-vjeçare të Presidentit Milo Gjukanoviç. Euronews raporton se kjo ishte protesta e tretë në të cilën kërkohet dorëheqja e Presidentit. Protesta po ashtu kishte në fokus edhe transmetuesin shtetëror "Radio Televizija Crne Gore". Protestuesit u mblodhën para selisë së televizionit në orën 19:30, që përkon edhe me nisjen e edicionit kryesor të lajmeve. Protestuesit, shumica e të cilëve pa lidhje politike, por që tashmë gëzojnë mbështetjen e opozitës, kërkuar dorëheqjen e Presidentit Gjukanoviç, kryeministrit Dushko Markoviç dhe Kryeprokurorit Ivica Stankoviç. Gjukanoviç është lideri më jetëgjatë në Europë. 57-vjeçari është në pushtet prej pothuajse tri dekadash. Ai ka shërbyer si kryeministër i Malit të Zi prej vitit 1991 deri në vitin 1998 kur u zgjodh President dhe shërbeu deri në vitin 2002. Në vitin 2003 ai u rizgjodh kryeministër për të vazhduar me shumë qeveri deri në vitin 2016. Në Maj të vitit 2018 Gjukanoviç u rizgjodh president.

"Drejtesi, jo korrupsion", protesta antiqeveritare në Rumani

Qeveria po minon reformën në drejtësi, dekreti i emergjencës shkakton trazira

Drejtesi, jo korrupsion" janë thirrjet e këtyre më shumë se 10 mijë protestuesve antiqeveritarë në Bukuresht e qytete të tjera të Rumanisë. Ata protestuan natën e të dielës përpara selisë së qeverisë për të kundërshtuar dekretin e emergjencës që ndërhyr në funksionimin e sistemit të drejtësisë. De-

kreti i emergjencës i nënshtroi nga kryeministria socialdemokrate Viorika Dançila i heq të drejtën Prokurorit të Përgjithshëm Augustin Lazar të drejtë të hetimit ndaj ish-shefes së zyrës anti-

korrsion Laura Këvevi. Në këtë mënyrë, kryeprokurori Lazar e ka të pamundur të pushojë hetimet për abuzim me detyrën ndaj Këvevit të nisura me kërkesë të socialdemokratëve në pushtet.

Laura Këvevi u shkarkua korrumpion dhe vitit të kaluar si shefe e zyrës antikorrsion. Ajo shquhet për nisjen e proceseve të bujshme hetimore ndaj dhjetëra zyrtarëve socialdemokratë të akuzuar për

korrsion mes tyre edhe ish-kryeministrit Viktor Ponta. Komisioni Europian ka akuzuar qeveritë e fundit socialdemokrate në Rumani se me ndërhyrjet e tyre në sistemin e drejtësisë po minojnë reformën në drejtësi, që i mundësoi hyrjen vendit në Bashkimin Europian në vitin 2007.

Ngopja e tregut të punës, çfarë pritet të ndodhë brenda një dekade

Krizë ekonomike vitin e ardhshëm? Bota mund të zhytet në recesion

Amerika mund të ngadalësojë rritjen ekonomike në 2020



Me ngadalësimin e ekonomisë amerikane, dhe pastaj hyrjen e saj në recesion, do të nisë të vuajë edhe tregtia globale, dhe nga kjo vështirë se mund të shpëtojë eurozona, veçanërisht në vitin 2020. Por një përmirësim në bazat ekonomike të brendshme, mund të zbutë efektet e ngadalësimit ekonomik në këtë anë të Atlantikut. Ngopja e tregut të punës në eurozonë, e arrihur në vitet e fundit, do të nxisë më në fund reformimin e sistemit të pagave, me normën e rritjes nominale të të ardhurave familjare, që është gati të mbërrijë nivelin më të lartë në një dekadë. Çdo ngadalësim në 3-mujorët e ardhshëm, për shkak të dobësisë të perspektivave të punësimit, do të kompensohet ndoshta nga një ngadalësim i inflacionit, duke e mbajtur fuqinë blerëse në një trajektore të rritjes së moderuar. Për më tepër, nga pikëpamja e buxheteve, familjet në eurozonë mund të cilësohen financiarisht të shëndetshme. Pavarësisht nga rritja e kredive të konsumit, barra e tyre e borxhit mbetet e

ulët në pjesën më të madhe të vendeve. Në fushën e investimeve, eurozona ka një kërkesë të ulët për investime fikse, veçanërisht në sektorin e ndërimit. Kjo për shkak se cikli ekonomik në zonën e euros, është në një fazë më pak të maturuar se ai në SHBA. Me një pabarazi të madhe midis vendeve, bilancet e kompanive nuk janë aq të fuqishme sa ato të familjeve, edhe pse ato janë përmirësuar, si kompanitë e vendeve të goditura nga kriza e borxhit sovran që kanë rritur rezervat likuide, si dhe kanë diversifikuar burimet e financimit. Kjo duhet të ketë forcuar elasticitetin e tyre ndaj goditjeve financiare, edhe nëse mbeten disa zona të prekshme. Hapësira e manovrimit të BQE-së, për të normalizuar politikën e saj të normave të interesit, mund të mbyllet me shpejtësi brenda një viti. Sipas mendimit tonë, BQE mund të rrisë disi nivelin e depozitave në fillim të vitit 2020, përpara se të ndërprejë planet e tij të kufizimit të politikës monetare. Ndërkohë ekonomia e Kinës,

do të vazhdojë të ngadalësojë gjatë 2 viteve të ardhshme. Tranzicioni i vështirë i Pekinit, nga një model i rritjes së shpejtësisë të lartë, drejt një modeli të vlerës së shtuar, po eliminon ngadalë nxitësit kryesorë të rritjes, duke frenuar rritjen e kredisë, dhe duke zgjeruar rolin e forcave të tregut, në kurriz të përfshirjes së shtetit. Pritet që autoritetet kineze, të jenë në gjendje të vënë në zbatim instrumente fiskale, dhe japin më shumë kredi për të parandaluar rënien e shpejtë të rritjes ekonomike. Ngadalësimi ciklik në ekonomitë e përparuar, dhe shtrëngimi i mëtejshëm i kushteve financiare, do të penalizojë tregjet në zhvillim. Nëse investitorët do të detyrohen të ulin më tej fluksin e investimeve, disa prej këtyre vendeve mund të kenë nevojë të përdorin ndihmën financiare ndërkombëtare. Kjo do të rrisë gjasat e një dukurie ngjitëse, edhe nëse një krizë që i prek të gjitha në tregjet në

zhvillim, mbetet e pamundur. Kur FED-i në SHBA të nisë të ulë normat e interesit, tregjet në zhvillim mund të përfitojnë prej saj, por nuk është e qartë nëse kjo do të jetë e mjaftueshme për të kompensuar ngadalësimin e shkakuar nga rënia e flukseve tregtare globale, dhe rritja e rreziqeve në tregjet financiare. Ekzistojnë disa rreziqe që nderen mbi perspektivat makroekonomike, shumica e të cilave nuk varen vetëm nga faktorët ekonomikë dhe financiarë, por nga vendimet e këqija politike. Këtu përfshihet, një përshkallëzim i mundshëm i tensioneve tregtare SHBA-Kinë, mungesa e marrëveshjes me BE dhe Britaninë mbi Brexit, një përkeqësim i problemeve ekonomike në Itali (me një ndikim negativ në vendet e tjera të eurozonës), dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, një ngadalësim më i madh i rritjes ekonomike në Kinë.

Marrë nga Bota.al

SHKURT

154 të vdekur nga alkooli i kontaminuar

Të paktën 154 persona kanë humbur jetën dhe më shumë se 200 të tjerë janë shtuar në spital pasi kishin konsumuar pije alkoolike të kontaminuar në Indi. CNN raporton se viktimat kishin konsumuar alkool të pakontrolluar, prodhuar në mënyrë artizanale dhe të paligjshme në shtetin e Assamit, në verilindje të Indisë. Policia tha se bilanci i viktimave u rrit të hënën në 154 të vdekur nga 133 që ishin të dielën. Policia ka arrestuar deri më tani 34 persona si të përfshirë në furnizimin me alkool të paligjshëm. "Është pije ilegale që është prodhuar në këtë rajon. Ende po hetojmë përbërjen", tha Mukesh Agarwal, një zyrtar i lartë i policisë në shtetin e Assamit. Rastet e para të kontaminimit u raportuan pasditën e së enjtes dhe shumica e viktimave ishin punëtorë në fusha çaji. India ka ndërmarrë një betejë të ashpër kundër alkoolit të paligjshëm, i cili konsumohet nga shtresat e varfra të shoqërisë indiane. 80 persona vdiqën në muajin shkurt në shtetet Uttar Pradesh dhe Uttarakhand pasi konsumuan pije ilegale të prodhuara në mënyrë tradicionale. Në vitin 2015, 100 persona vdiqën në Mumbai, ndërsa në vitin 2011, 168 persona humbën jetën në Bengal Perëndimor pas konsumit të pijeve të pakontrolluara.

Kinë, aksident në një minierë humbin jetën 21 persona

21 të vdekur dhe 29 të plagosur është bilanci i një aksidenti me 50 minatorë të ndodhur dje në mëngjes në minierën më të madhe të argjendit në Kinë, e menaxhuar nga Yinman Mining. Mjeti është përplasur në një tunel, gjatë transportimit të minatorëve, si pasojë e një problemi në sistemin e frenimit. Një grup është dërguar nga qeveria për të parë dhe hetuar për ngjarjen e rëndë. Yinman Mining është një degë e Inner Mongolia Xingye Mining, gjigandi i minierave, i cili prodhon rreth 201 ton argjend në vit. Kina është prodhuesi i tretë më i madh në botë bazuar në të dhënat për vitin 2017, me një total prej 2,500 tonë, që është pak më shumë se dyfishi i asaj që prodhon SHBA.



Kryeministria britanike, Theresa May, ka anashkaluar për pak kohë politikën, ndërsa ka sfiduar në një lojë bilardoje homologun italian, Giuseppe Conte. Ajo ka treguar se nuk di të luajë, por i ka kërkuar kryeministrin italian që ta ndihmojë. "E di se do të më ndihmoni shumë, por prapë se prapë nuk du të di të luaj. Më tregoni si duhet ta bëj".

DOKUMENTARI

Studimi për Kinostudion, shfaqet "amaneti" i fundmë i GËZIM QENDROS

Fatmira Nikolli


Gëzimi mendonte se in teligenca mbivlerësohet. Është dashuria ajo që e bën njeriun. Dhe unë e di që të gjithë ju që jeni këtu sonte keni ardhur nga dashuria dhe ju falenderoj të gjithëve ju dhe Edin, Lindën e Zahon". Me këto fjalë e hapi mbremjen Arta Marku, bashkëshortja e Gëzimit Qendros.

Pothuaj 1 vit pas ikjes së tij, është shfaqur mbremë në kinema "Millenium" dokumentari "Enigma e Kinostudios", bazuar mbi studimin e Gëzimit Qendros për godinën e ish-Kinostudios.

Me skenar të Anisa Ymerit, filmi dokumentar i prodhuar nga RTSH, hedh dritë mbi studimin dhe simbolikat e krishtera që gjenden te godina e ndërtuar në komunizëm, që nga forma e kryqit të vetë ndërtesës, te kubeja, kryqji mbi kube e mbajtësja e ujit të bekuar. Kjo që ndër punët e fundme të Qendros para se të shuhej. Ai pat botuar studimin dhe pat hedhur idenë e filmit, kur një vit më parë u nda nga jeta në moshë ende të re, me shumë punë në duar për shkak të një sëmundjeje të rëndë. Dokumentari përfshinte intervista me Qendron, Pirro Thomon, Mevlan Shanajn, Timo Fllokon, Endri Markun etj., të cilët jepnin paralele mes Kinostudios, kishave bizantine dhe ndërtesa të Ish-Bashkimit Sovjetik. Miq, të njohur, kolegë, studentë, artistë dhe kryeministri i vendit morën pjesë në shfaqjen e filmit.

STUDIMI

Autori ngre pyetjen "...si mundet që dy regjime totalitare, ai



Filmi dokumentar për godinën me simbolika të krishtera

sovjetik dhe ai shqiptar, armiq të betuar të institucioneve fetare, të kishin ideuar ngritjen e një 'vepre të rëndësishme pesëvjeçari' me planimetri në formë kryqi, e cila prej shekujsh njihet si planimetria standarde e ndërtesave të kultit të krishterë...". Këtu nis edhe ndjekja me përkushtimin, siç e ka në stilin Gëzimit Qendro, bollëkun e fakteve, të cilat shtrihen në një rrugë të gjatë, që nga projektuesit, ata që e pranuan, ata që e ndërtuan e deri tek ato që e inauguruan. Në fund esteti Qendro e mbyll me një harmoni midis dy kuptimeve që kjo ndërtesë vizatonte, njëri i shenjtë dhe shërbente për pastrimin shpirtëror apo shëlbimin e njeriut dhe tjetra, kryesor-

ja e sistemit komunist apoteozën e Njeriut të Ri me heronjtë, sekretarët e partive apo punëtorit pa arsim të lartë, por me një inteligjencë dhe humanizëm të paanë, i cili kishte fuqi t'ia "mblidhte" drejtorit apo zëvendësministrit burokrat. Një pjesë me interes i librit dhe e trajtuar me mjeshtri dhe humor të hollë është epilogu 'Kujtesa si hapësirë heterotopike'. Autori duke punuar në këtë institucion ka parë në dy variante personazhet, si xhirohej dhe si ishin në kohë të lirë. Armiq në film si ballist apo partizan, por që në pritje të xhirimit pinin kafë me njëritjetrin, sigurimi me diversantin me mjekër të parruar që rinin së bashku, oficer nazist me një komit



të pavarësisë që diskutonin së bashku për futbollin dhe vendin që do të zinte Ajaksi në kampionatin e futbollit, ose Ismail Qemali kryeministri i parë i Shqipërisë (interpretuar nga Sandër Prosi), shijonte në qetësi diellin pranveror; në pritje të dublit tjetër në atelierin e ri etj., etj. absurditete për kohën. Këtë liberalizëm në oborrin e Kinostudios, autori e dëshiron të ishte edhe jashtë këtyre mureve. Por, a mund të bëhej një gjë tilla kur diktatura e proletariatit shpiku vrasjen e armikut. Nga ky zbulim, kritiku i njohur i artit shqiptar, Gëzim Qendro shkruante: "...Mbeta i shtangur pa u besuar syve. Çudi, si nuk e kisha vënë re më parë, në atë ndërtesë kisha punuar gati dhjetë vjet! Dhe nga ajo kohë kishin kaluar edhe plot gjashtëmbëdhjetë vite të tjera! Me sa duket, edhe unë, ashtu si hutini i Minervës, duhej të prisja të binte muzgu i his-

torisë', për të 'parë' atë që dikur e kisha pasur para syve. Por, ndryshe nga hutini që zbulon duke vëzhguar me sytë e tij të mprehtë, zbulimi, si të thuash, "m'u shfaq vetë

Ikja e Qendros". Gëzim Qendro ndërroi jetë në moshën 60-vjeçare pas 1 vit përpjekjeje kundër sëmundjes së pashërueshme. Me studimet e tij të botuara brenda e jashtë vendit, Gëzim Qendro krijoi një vetëdije që mendimi kritik shqiptar në artet pamore të futet në rrjedha moderne. Si profesor në auditorët e Tiranës dhe Prishtinës, ai ka kontribut për krijimin e bazave të edukimit artistik. Përveç përkthimeve të panumërta mbi historinë dhe teorinë e artit, Qendro është autor i disa monografive për artistin dhe artistët shqiptarë si, "Arkeologjia e Mëngjesit", "Heronjtë janë të uritur", "Surrealizmi socialist", (I'Harmattan) dhe "Kinostudio - Shqipëria e vjetër".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



FILMI



"SKËTERRË"

Dritëhijet e filmit të 1980-s, që ishte në listën e asgjësimit

Fatmira Nikolli

Revoltë në një kamp përqëndrimi fashist në vitin 1943 kundër metodave barbare e terrorit. Të burgosurit kryengritës si: profesori piktori Hekurani, Ariani, Mira, Shpresa organizohen dhe mbajnë lidhje të vazhdueshme me rezistencën jashtë kampit. Me rezistencë të fortë ata arrijnë të shkatërrojnë skëtërrën fashiste.

Ky është sinopsi i shkurtër i një filmi të shfaqur pak. Aludohet se duke përdorur si 'pretekst' fashizmin, artistët kanë goditur metodat komuniste.

Me regji të Rikard Ljarjes e skenar të Bashkim Shehut, muzikë të Zef Çobës ai u realizua nga Kinostudio "Shqipëria e Re" me 1980. Zgjaste 92 minuta.

Vetëm dy vite më vonë ai ishte në listën e filmave që do asgjësoheshin. Mehmet Shehu ishte vetëvrarë, të tjera familje ishin shpallur armike e mes tyre edhe Bashkim Shehu, djali i ish-kryeministrit.

Një dokument i dëshmon fare mirë fushatën e spastrimeve ideologjike në botime, art, muzikë, kinematografi, etj. Në listë është edhe filmi "Skëtërrë '43" dhe poshtë tij është shënuar arsyeja: skenarist është djali i armikut të popullit. Bashkim Shehu, sot shkrimtar dhe përkthyes aktiv me banim në Barcelonë ndërsa dokumenti është i shtatorit 1982, pra disa muaj pas vdekjes së të atit.



Filmi i ndaluar me skenar të Bashkim Shehut

RISHFAQJA

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit shfaq të mërkurën, më 27 shkurt, ora 19:00, filmin emocionues

'SKËTERRË '43' (1980), në Kinema Agimi, në 35mm. Prapaskenat e këtij filmi, janë po aq dramatike sa dhe ngjarjet në film që bazohen



“
Revoltë në një kamp përqëndrimi fashist në vitin 1943 kundër metodave barbare e terrorit. Të burgosurit kryengritës si: profesori piktori Hekurani, Ariani, Mira, Shpresa organizohen dhe mbajnë lidhje të vazhdueshme me rezistencën jashtë kampit.

në Luftën e Dytë Botërore. Në 1980, aktori dhe regjisori Rikard Ljarja i kërkoi Bashkim Shehut, djalin të kryeministrit Mehmet Shehu, të shkruante skenarin e 'SKËTERRË '43' ndërsa teknikët e Kinostudios ndërtuan në shkallë reale një burg italian buzë detit. 'SKËTERRË '43' i ofroi role të paharueshme aktorëve të rëndësishëm si R. Ljarja, Xhevdet Ferri, Birçe Hasko, Agim Qirjaqi, Violeta Deda dhe Mario Ashiku. Dukej sikur asgjë s'do e prekte punën e arrijrë të stafit, kamerën e guximshme të drejtorit të fotografisë Saim Kokona dhe muzikën goditëse të kompozitorit Zef Coba. Por, në

1981 Mehmet Shehu vdiq në rrethana misterioze. Pasi u shfaq shumë rrallë, filmi u ndalua dhe hyri në listën e filmave të ndaluar... Disa e shohin filmin 'SKËTERRË '43' si reflektim delikat dhe të rrezikshëm mbi jetën në Shqipërinë komuniste. Ju ftojme të vini e të vendosni vetë! Bileta kushton 300 lekë. / Shfaqja e tretë e kinematekës: Pranverë 2019 - "Thesaret e Arkivit" - program i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit i kuruar dhe prezantuar nga personalitete të mendimit dhe humlunitimit bashkëkohor. E mërkurë, në 27 shkurt, ora 19:00, në Kinema Agimi, në gjuhën orgjinale - shqip.

Opinion i Ditës

Zgjedhje të lira + Nëntë

Nga dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

...të anëtarësimit në BE; sidomos tani që zgjedhjet lokale po na frondasin të porta, të paraprirura nga kriza më e re politike.

Sepse asnjë reformë tjetër, madje as ajo e drejtësisë dhe vetingu nuk mund të ketë besueshmëri dhe sukses afatgjatë pa zgjedhje të liru dhe të ndershme, prej të cilave dalin qeveria dhe organet e tjera të pavarura legjitime, që garantojnë funksionimin normal të jetës demokratike.

Por, kohët e fundit, në shumë takime dhe forume evropiane, prej rajonit dhe veçanërisht vendit tonë po kërkohet vëmendje e veçantë në dy aspekte jetike:

Së pari, është momenti që më në fund të kemi zgjedhje të lira dhe të drejta sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, që të mos vazhdojmë të kënaqemi refrenin se ishin "më mirë se zgjedhjet e kaluara".

Mirëpo, për të qenë të sinqertë dhe realistë, kjo është vështirësuar së tepëri për shkak të përvojës negative zgjedhore të 25 viteve të fundit, sidomos të mungesës së transparencës mbi financimin e fushatave zgjedhore nga partitë politike, korrupsionit galopant, kiritimit të organizuar dhe politizimit të administratës publike etj., për pasojë, të ne janë shfaqur dukuri dhe fenomene të panjohura për komunitetin ndërkombëtar, madje edhe fqinjët tanë, si vjedhja/shitblerja e votës; tani dhe të huajt janë mësuar me këto terma, por në fillim ata ngrihen supet të habitur kur dëgjojnë premtimin tonë se "do ta mbrojmë votën edhe me gjak". Dukuritë e lartpërmendura i kanë kompromentuar rëndë zgjedhjet të ne, duke i zhveshur në një masë të madhe nga elementi "të lira dhe të ndershme", duke i katandisur pothuajse në "votime" pluraliste me pasoja tashmë të njohura, me riciklime krizash dhe konfliktesh të ashpra që kanë penguar seriozisht përparimin, integritimin dhe imazhin e vendit.

Ndaj, reforma e tanishme zgjedhore nuk mund të mjaftohet me rregullime teknike e ca më pak kozmetike, apo vetëm në "germa". Në radhë të parë kërkohet që të jetë reformë për "frymën" e zgjedhjeve, të çliuara nga të këqijat e lartpërmendura, duke atakuar edhe vetë thelbin e saj, sistemin zgjedhor të vendosur në vitin 2009. Përvoja e 10 viteve të fundit, vërejtjet dhe rekomandimet e vazhdueshme të OSBE-së imponojnë drejtpërsëdrejti shqyrtimin kritik dhe ndryshimin e saj, nëse duam vërtet zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Ndërkohë, sidomos kjo reformë kërkon konsensus gjithëpartiak dhe publik. Mirëpo në kushtet e tanishme të tensionimit të paparë politik mes opozitës dhe shumicës qeverisëse, kjo duket mision pothuajse i pamundur; ose në rastin më të butë kjo reformë mund



të bëhet shkel e shko, sa për të kaluar radhën.

Shqetësimi i dytë madhor është se dhe (si)kur këto zgjedhje të zhvillohen vërtet të lira dhe të ndershme, edhe pse jo perfekte, sërish kjo nuk mjafton dhe nuk e imuniton demokracinë nga dukuritë negative. Përvoja evropiane e shekullit të kaluar ka plot shembuj që tregojnë se si nga zgjedhje formalisht të lira pluraliste kanë dalë liderë dhe forca antidemokratike dhe ekstremiste, të cilët kanë shkaktuar tragjedi botërore.

Por, edhe në ditët tona nga zgjedhjet e lira dhe të ndershme në Itali, Austri dhe gjetkë kanë ardhur në pushtet forca dhe liderë populistë, ekstremistë dhe nacionalistë, të cilët më e pakta po kërkojnë të çmontojnë ose "ribëjnë" BE-në, të zëvendësojnë shtetin e të drejtës me "demokracinë joliberale", etj. Këtu përfshihen edhe vende ish-lindore që kanë qenë në ballë të shembjes së mureve të komunizmit, hapjes së kufijve, ndërtimit të urave, adriminit në BE, NATO dhe në organizmat e tjera ndërkombëtare.

Kësisoj, vijmë në përfundimin tjetër as aderimi në BE dhe NATO nuk përbën më garanci për demokracinë, pavarësisht nga zgjedhjet e lira dhe të ndershme.

Sepse këto të fundit, edhe kur zhvillohen në perfekcion, nuk janë më "kura apo çelësi magjik" për zgjidhjen e problemeve të shumta që ka sot demokracia kudo dhe në vend më të zhvilluara e përparura se vendi ynë, madje edhe themelues të BE e NATO-s.

Në këto kushte, garancia më e mirë është që duke vlerësuar drejt rëndësinë e tyre, këto zgjedhje të mos shihen dhe zhvillohen si qëllim në vetvete, e ca më pak të glorifikohen apo "shenjtërohen".

Përkundrazi, ato duhet detyri-

miisht të paraprihen, shoqërohen dhe bashkëjetojnë në bllok me nëntë komponentët e tjerë të mishëruar dhe të Dekalogun e famshëm të Ahtit Final të Helsinkit të vitit 1976 dhe në dokumente të tjera ndërkombëtare. Jo rastësisht zyra prestigjioze vëzhguese e OSBE-së për zgjedhje të lira ka një emërtim shumë më të gjerë "ODIHR" - Organizata e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut.

Hapi i parë i madh, sidomos nga çdo shumicë parlamentare është të mos e fetishizojnë votën, të mos e përdorin atë si "gjethe fiku" dhe "plumb" për kundërshtarit, si aureolë dhe plotfuqishmëri për të vepruar sipas qejfit/tekave dhe jo parimeve, me argumentin se "ne na ka besuar elektorati". Dakord, por ama ai të ka besuar si alternativa më e mirë për zgjidhjen e hallevë dhe problemeve, e jo duke anashkaluar e shkelur nëntë elementët e tjerë që sapa filluam t'i përmendim.

Gjithashtu, shumica parlamentare duhet të respektojë me të gjitha format opozitën, ashtu siç ajo është, shqiptare, duke e dëgjuar, duke i dhënë hapësirë dhe mundësi brenda dhe jashtë vendit, duke dialoguar me kulturë demokratike për të gjitha çështjet e sidomos për ato të anëtarësimit në BE, sigurisë së vendit e diplomacinë. Vegse me një gjuhë politike korrekte, pa etiketime dhe batuta ofenduese, insinuat, meme, barsolata.

Natyrisht, edhe opozita duhet të shfrytëzojë këto mundësi duke konkurruar me programe dhe alternativa e jo duke u konfliktuar apo konfrontuar me vend e pa vend me shumicën parlamentare dhe për vetë emrin dhe rolin e kësaj të fundit.

E tepërt të zgjatemi në deficitet dhe shqetësimet tejet serioze në

këtë fushë nga të dyja palët. Madje, hera-herës, siç po ndodh edhe tani, në vend të bëhet përpara ecet mbrapsht, edhe pse të dyja palët kanë përvojë të madhe si në pushtet dhe në opozitë. Sepse edhe opozita ka deficite të mëdha në këtë fushë që janë trajtuar gjerësisht në shtyp, duke filluar nga besueshmëria, forca e alternativave, metodat e punës dhe kohezionit brenda saj.

Gjithashtu, të dyja palët e sidomos shumica duhet të kufizojnë në minimum tendencat për penalizimin e njëri-tjetrit, duke "përmbytur" gjykatat me lumenj padish e duke zëvendësuar atë me debatin politik dhe publik e në bashkëbisedim me qytetarët.

Shtypi dhe media e lirë dhe e pavarur kanë luajtur një rol parësor në formimin e opinionit publik. Dihet përparimet e shumta teknologjike në median tonë, por jo të shoqëruar sa duhet me përmbajtjen, pavarësinë dhe konstruktivitetin, duke bërë hapa mbrapa. Gjithsesi, krahas kujdesit dhe profesionalizimit të medias, luftës ndaj "fake news" etj., nuk ndihmon përgjithësimi me etiketime të papëlqyeshme dhe të paparueshme me frymën evropiane, sidomos kur kjo vjen nga agjenci dhe ekspertë qeveritarë.

Shoqëria civile dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën komponentin tjetër shtyllë të demokracisë. Veç Kartës të të Drejtave dhe Konventës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, këto të fundit zënë një kapitull të veçantë në Kriteret e Kopenhagenit të BE-së. Katalogu i tyre është shumë i larmishëm, duke filluar nga e drejta e punës, pronës, jetës, sigurisë, arsimit, liria e grumbullimit dhe manifestimit i paqësor, liria e shprehjes dhe mendimit dhe plot të tjera. Komponent themelor këtu është mospis-

kriminimi për shkak të bindjeve të ndryshme politike, fesë, ngjyrës, racës, gjinisë etj.. Me gjithë arritjet e njohura, pengesat dhe problemet në këtë fushë janë një sfidë e madhe për përparimin e mëtejshëm të reformave demokratike. Protestat e fuqishme të studentëve gjatë këtij muaji dëshmuuan se e drejta për arsim të lartë publik ka mbetur në letër.

Mbrojtja, respektimi dhe zhvillimi i të drejtave të pakicave etnike, gjuhësore etj., është treguesi tjetër jetik i demokracisë. Vendi ynë në këtë drejtim ka krijuar një përvojë pozitive, "në frymë dhe në germa" që krahasohet, madje në shumë raste ua kalon dhe disa vendeve anëtare të BE-së, ndërsa lidhur me bashkëjetesën fetare është model i njohur ndërkombëtarisht. Dihet tashmë përpjekjet për t'i kthyer pakicat në ura lidhëse, bashkëpunimi dhe miqësi. Nuk ia ka arritur gjithnjë për shkak të disa qarqeve të caktuara ekstremiste që huaja që vazhdojnë t'i përdorin pakicat dhe fenë si billoqe penguese, si vatra për kriza dhe konflikte sa herë ua kërkojnë interesat e brendshme apo të segmenteve ekstremiste që bien nësh me frymën evropiane.

Ndarja e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe atij gjyqësor ka qenë dhe mbetet ndër sfidat kryesore të dekadave të fundit. Sidomos pavarësisht e pushtetit gjyqësor dhe drejtësisë në përgjithësi dhe transparencën e kësaj të fundit. Sepse populli kërkon jo vetëm të bëhet drejtësia, por edhe të shihet që ajo po bëhet. Procesi i vetingu dëshmon për problematikën ulëritëse në këtë fushë deri tani dhe nevojën që krahas përpjekimit të kësaj reforme dhe ngritjes sa më parë të organeve mbikëqyrëse përkatëse të ketë dhe besueshmërinë e duhur mbi-partiake.

Vërtet siç pohojnë dhe të huajt ka rritje të numrit të arrestimeve, por puna matet me dënimet konkrete dhe mbi të gjitha me dhënien e drejtësisë. Madje, në vend të shprehjes së rëndomtë "arrestime dhe burgime" është më e drejtë të përdoret termi "t'i jepet drejtësisë, të bëhet drejtësia".

Kjo e fundit është vendimtare për lirinë dhe demokracinë e vërtetë dhe funksionale.

Kësisoj, shteti i të drejtës do të zbatohet drejt në praktikë, jo thjesht si shtet ligjesh, por sipas parimit se "ligji sundon mbi të gjithë njëlloj".

Si përfundim, në kushtet e tanishme, kur opozita ka shkuar në ekstrem duke "djegur" kolektivisht mandatin e deputetit, zgjedhjet e ardhshme vendore dhe të përgjithshme, të pashoqëruara e të pagarantuar me nëntë komponentët thelbësorë të lartpërmendura mund të kthehen, siç ka ndodhur edhe më parë, në kriza, farsa dhe zgjedha të vërteta, me pasoja të pariparueshme për shtetin, shoqërinë dhe të ardhmen tonë Euro-Atlantike.

Opinioni *i* Ditës

Imagjinoni zgjedhje si tonat në Anglinë tuaj, z. Wilton!

Nga Koço Kokëdhima

(vijon nga faqja 1)

... së një anglezi më mbeti në fytyrë kur folët për zgjedhjet shqiptare. Thate: "Ka patur probleme me shitblerjen e votës: Po! A mund të ndryshonin këto rezultatit zgjedhjeve: Jo! A është vetëm një subjekt me këto probleme: Jo! Votuesit kanë patur mundësi për të shprehur zgjedhjen e tyre, pasi e kanë vetë në dorë".

I nderuar z. Wilton, më vjen keq, por jeni disa herë gabim. Qoftë nga pozicioni juaj si zambasador i OSBE-së, qoftë si mik dhe njohës i problemeve të Ballkanit, qoftë nga profesioni juaj si shkrimtar, qoftë edhe nga fakti se jeni anglez.

Po ju bëj një panoramë mikse që do t'u ndihmojë juve, që të kuptoni problemet me zgjedhjet në Shqipëri, që ju si anglez, edhe pse numri dy i OSBE-së prej vitit 2013 në Shqipëri nuk i paskeni kuptuar.

Zgjedhjet këtu u vranë më 26 maj 1996. Besoj e dini se çfarë ndodhi atëherë në Shqipëri. E majta u tërhoq nga komisionet e votimit, sepse manipulimet ishin flagrante, ndërsa e djathta e Sali Berishës, atëherë presidenti, përfitoi dhe me makutëri mbushi kutitë e votimit, dhe rezultati ishte edhe...120 për qind në favor të PD-së. Qesharake dhe tragjike...Besoj e keni dëgjuar emrin e një zonye që është britanike si dhe ju. Audrey Glover uqhet. Ishte kryesuese e zyrës së ODIHR-it dhe misionit i quajti të paprueshme dhe të pavlefshme këto zgjedhje, rezultatin e të cilave do ta kishte zili edhe ish-diktatori komunist që fitonte me 99 për qind të votave.

Berisha ende e urren zonjën Glover, sepse e preku të ëndrra e tij për t'u vetëshpallur mbret në një republikë parlamentare. Por juve jo. Sepse ju, deri më sot, keni legjitimuar lojën e tij dhe të gjithë mbase me të në politikë.

Kam votuar ngjashmë pranë vendbanimit tim. Në komisionin ishin fqinjët e mi. Një me PD-në, tjetri me PS-në, tjetri me LSI-në...dhe ca nga ata që nuk e pëlqenin orientimin tim politik më shihnin shtrumbër. Kështu ka qenë jetë e mot, po aq kohë sa ka OSBE-ja juaj në Shqipëri. Për ju si anglez është çmenduri një administratë e tillë zgjedhore, por këtu është e tillë prej 28 vitesh. Dhe ju si OSBE nuk ua keni prishur skemën partive politike shqiptare që administrojnë zgjedhjet, si në asnjë vend tjetër demokratik të botës. Më thoni një vend tjetër në Europë, ku zgjedhjet bëhen si në Shqipëri, ku ato i organojnë tri parti pjesëmarrëse? PS, PD dhe LSI kanë përfaqësues në KQZ, kanë anëtarët e tyre në KZAZ, kanë edhe anëtarët e tyre në Grupet e Numërimit të Votave. Partitë e tjera mund të kenë vetëm vëzhgues që duhet të rrinë në distancë që çpërkatojnë shiritat kufizues nga ku nuk mund të shohin se si numërohet vota e tyre. E imagjinoni këtë të ndodhë në Anglinë tuaj, z. Wilton?

E imagjinoni që Laburistët dhe Konservatorët të kenë në dorë komisionerët në të gjithë hierarkinë e tyre dhe ata të vendosin kë votë duhet të kalojnë si të tyren dhe kë si të partive të tjera? E imagjinoni ju taghmën



tjetër të zgjedhjeve shqiptare që në një qendër votimi mund të votohet, por nuk mund të numërohet dhe kutitë e mbushura me vota duhet të transportohen nga këta militantët e tri partive për në komisionet e numërimit pranë ZAZ-ve dhe si zakonisht rrugës ato "përpunohen" dhe më pas u dorëzohen po komisionerëve zonalë të këtyre tri partive?

Ju sugjeroj që të lexoni ndonjëherë nga dosjet e prokurorisë për zgjedhjet shqiptare, bie fjala dosjen "Ruzhdia", që mban emrin e një fshati në jug të Shqipërisë, ku dhe ju siguroj se novela, zhanri juaj i preferuar si shkrimtar, që mund ta trajtojë si subjekt, do të jetë një bestseller në Perëndim. Këto realitete të mjera shqiptare do t'u duken fantasti të shfrenuara lexuesve perëndimorë.

Ju përmendni zgjedhjet e fundit, ato të 25 qershorit 2017. Pranoi se ka patur probleme me shitblerjen e votës, por se ato nuk mund ta ndryshonin rezultatit. Por ja çfarë ndodhi realisht:

Nga rinumërimi i 64 kutive të qarkut të Tiranës me kërkesë të PDIU-së dhe PS-së doli në pah elementi i konsumimit të veprës penale nga dhjetëra numërues. Nga 64 kuti, vetëm 7 tabela rezultatesh përputheshin me votat që ndodheshin brenda kutisë. Në 57 kuti të tjera votat ishin tjetër-suar dhe numërimi i parë me atë të dytin nuk përputheshin thuasje në asnjë parti. Në total, Partia Socialiste kishte marrë padrejtësisht 69 vota më shumë, ndërsa Partia Demokratike 47 të tilla. LSI-ja ka marrë padrejtësisht 74 vota më shumë, ndërsa PDIU është e vetmja me bilanc negativ, ku edhe pse i kishin hequr 5 vota në total, ajo vetë kishte përfituar padrejtësisht 52 vota, ndërsa i kishin marrë 57 të tilla.

Nga këto lëvizje vërtet nuk ndryshonte rezultati në nivel qarku, por së pari duhet të dini se ka edhe shumë manipulime të tjera që nuk mund të dokumentohen nga rinumërimi i kutive, dhe së dyti, duket sheshtë se shumë numërues të partive kanë konsumuar veprat penale të falsifikimit të materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve, parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal dhe për ta dënuimi do duhet të ishte me burgim 3-7 vjet.

Partia ZGJIDHJA e kishte parashikuar këtë maskaradë zgjedhore, ndaj i bojkotoi këto zgjedhje. Duke marrë shkas nga rinumërimi në Tiranë dhe legjitimiti që ndërkombëtarët u kanë bërë sistematikisht zgjedhjeve

shqiptare, në cilësinë e kryetarit të partisë ZGJIDHJA, më 18 korrik 2017, u dërgova një letër ambasadorit të OSBE-së, Bernd Borchardt; ambasadorit Peter Tejler, kreu i Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të 25 qershorit si dhe për djegin z. Donald Lu, ish-ambasador i SHBA-ve dhe Romana Vlahutin-it, ish-ambasador e BE-së. Aty shprehej shqetësimi për hapin prapa që u bë në zgjedhjet e 25 qershorit si dhe u kërkohet partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë që të vendoseshin përfundimisht në anën e popullit shqiptar dhe jo në anën e politikave të korruptuara e autoriteteve të Tiranës që blejnë, vjedhin dhe manipulojnë zgjedhjet me paratë e marijuanës dhe të krimtimit, sepse pa zgjedhje të lira dhe pa demokratizimin dhe modernizimin e partive politike ky vend nuk do të ketë as përparim, as liri të vërtetë dhe as stabilitet.

Me këtë shqetësim, kërkova takim me shefin tuaj, ambasadorin Borchardt, dhe ai u bë në zyrat tuaja, më 12 tetor 2018.

I thashë eprorit tuaj se Shqipëria ka probleme të mëdha me zgjedhjet, se ato nuk janë të lira dhe të barabarta. Në vend të zgjedhjeve të lira, në vend të sundimit të ligjit, në Shqipëri sundon marrëveshja PS-PD. Ato kanë zëvendësuar praktikisht institucionet demokratike të një republike. Rekomandimi kryesor i OSBE/ODIHR-it, sipas partisë ZGJIDHJA, prej të cilit varet çlirimi i zgjedhjeve, është depolitizimi i tyre.

Misioni juaj mendon se administrimi i zgjedhjeve mund të vazhdojë të bëhet nga PS dhe PD, edhe pse Shqipërisë i nevojitet një depolitizim i plotë i administratës zgjedhore. Mirëpo për këtë duhet domosdoshmërisht që në krye të procesit zgjedhor të jetë një institucion me njëzë kretësisht të pavarur nga partitë.

PS dhe PD thonë sot se KQZ-ja jonë, që është siç ka qenë, do të vazhdojë të drejtojë dhe administrojë zgjedhjet, do të marrë vendimet decizive për zgjedhjet, do të licencësojë dhe kualifikojë anëtarët e komisioneve të tjera. Trupa që duhet të administrojë zgjedhjet nuk duhet t'i nënshtrohet një selektimi nga kriteret që vendos KQZ-ja e PS+PD+LSI. Ajo duhet të përbëhet nga njëzë zgjedhjen për shkak të një cilësie ekstrapartiake, si p.sh., janë punonjës të bankave, profesorë të universiteteve, noterë, gjykatës, prokurorë,

studentë ekselentë etj.

Depolitizimi i KQZ-së dhe çlirimi i zgjedhjeve nga administrata partiake është ndryshimi i parë thelbësor dhe i rëndësishëm për demokratizimin dhe pastrimin e zgjedhjeve.

OSBE-ja me të drejtë ka kërkuar që zgjedhjet të mos prodhojnë diskriminim për askënd dhe në rastin konkret, pa kontributin e organizimeve ndërkombëtare, veçanërisht të OSBE/ODIHR-it, nuk mund të hiqen pengesat artificiale mbi partitë e reja dhe joparlamentare dhe nuk mund të bëhen zgjedhje të lira dhe të barabarta, ashtu siç e përkufizon Kushtetuta e Shqipërisë.

Z. Wilton! Në Shqipëri janë enuar qartësisht dhe diskriminohen partitë e reja gjatë zgjedhjeve. Dy-tri parti i ndajnë me marrëveshje në tavolinë votat e partive të tjera. Partitë e reja janë si fillizat e rinj që sapo janë mbjellë dhe partitë e vjetra ua marrin votat, sepse liderët e tyre nuk duan konkurrencë, nuk duan pluralizëm, nuk duan askënd që t'ua prishë ëndrrën për ta sunduar përjetësisht këtë vend. Në këto kushte këtu s'mund të lindë kurrë një elitë e re politike. N.q.s. një partie këta i mohojnë 5 deri në 10 vota për çdo qendër votimi, i bie që në rang republike PS dhe PD t'i vjedhin kësaj partisë në fjalë, 27 mijë deri në 53 mijë vota. Ju kujtoj i nderuar zv/ambasador i OSBE-së se PS dhe PD nxjerrin deputetë me 5-6 mijë vota. Kështu këto dy parti-kuçedra, nuk e lejojnë këtë partinë e të të ketë dyfishin e votave dhe të depulvetëve në zgjedhjet e ardhshme, sepse e gllabërojnë dhe e zorojnë gjithë në sprovën e parë. Dhe në këtë rast ju thoni se rezultati i zgjedhjeve nuk u ndikua nga ky krim monstruz, sepse kjo foshnja politike që vdiq nuk që aq e madhe dhe nuk mund ta ndryshonte raportin e forcave!

ZGJIDHJA e ka thënë shpesh se nëse zgjedhjet s'janë të barabarta dhe nuk administrohen në mënyrë të besueshme, individët më të mirë të Shqipërisë nuk do të kenë kurajon për t'u përfshirë në politikë dhe Shqipëria kurrë s'do të jetë një partnere e vlerave europiane.

Zgjedhjet që ju përmendët ishin, sipas jush, "një hap përpara", por për shqiptarët ishin një maskaradë zgjedhore, e certifikuar nga OSBE/ODIHR-i.

Kështu nuk mund të vazhdohet më. Fatqësisht ju i justifikoni deri në fund këto palo zgjedhje që u imponojnë shqiptarëve PS, PD dhe LSI, nën mbikqyren dhe mbrojtjen e OSBE-së. Imagjinoni, i dashur z. Wilton, sikur në Anglinë tuaj të bëheshin një palë zgjedhje të tilla! Populli shqiptar meriton të drejtat dhe standartet demokratike si të gjithë popujt e tjerë. Prandaj ju lutem të mos pajtoneni me paragykimet e disa njerëzve se populli shqiptar është i prapambetur dhe nuk meriton liritë dhe të drejtat që gëzojnë gjithë qytetarët e vendeve demokratike në botën e civilizuar.

ZGJIDHJA kërkon që çështja e zgjedhjeve në Shqipëri të mbyllet njëherë e përgjithmonë. Nuk ka një kohë tjetër për ta zgjidhur këtë problem. Nëse Shqipëria nuk e zgjidh këtë çështje, në besojmë që situata e saj do të vështirësohet akoma më shumë, ekonomia do të degradohet më tej dhe stabiliteti nuk do të jetë i dëshiruar.

HOROSKOPI

DASHI
Mos kaloni ditë duke zgjidhur problemet e të tjerëve. Duke vepruar kështu do t'ju digjen disa shanse që vijnë vetëm një herë. Përpuniqni të mos jeni pesimistë, pasi nuk ju ndikon aspak mirë në gjendjen tuaj psikologjike.

DEMI
Disa Demë do të jenë në kërkim të përgjigjes lidhur me një pyetje rreth marrëdhënieve tuaja personale. Ka gjasë që të keni dyshime për sinqeritetin e dikujt pranë jush. Partner/partnerja juaj mund të ndihet xheloz, për shkak të mikut/mikes suaj të ngushtë.

BINJAKET
Binjakët do të kenë fat në fushën e financave. Ka shumë mundësi që të fitoni disa të ardhura, për të cilat keni ditë që luftoni. Bëni kujdes me shëndetin dhe kushtojini vëmendje të veçantë dietës ushqimore dhe ushtrimeve fizike.

GAFORJA
Disa Gaforre do të zhvillojnë një sërë takimesh sot. Madje do t'ju duhet të komunikoni edhe me disa persona që në të kaluarën nuk keni pasur miqësi. Sot është disa e duhur për të bërë marrëveshje financiare. Ndërsa disa të tjerë do të kenë dëshirë të nisin një biznes të ri.

LUANI
Luanët do të përpunin të zgjidhin disa çështje burokratike. Keni çdo shans të mundshëm për të marrë lejen e nevojshme nga autoritetet përkatëse për të rimarrë një dokument ose për të shmangur çdo problem tjetër të mundshëm.

VIRGJERESHA
Disa persona të kësaj shenje mund të pësojnë dërrmim fizike, ndaj duhet të jeni shumë të kujdesshëm. Begërrit e kësaj shenje mund të zhvillojnë takime shumë interesante. Ka gjasë t'ju shfaqet ish-partneri juaj, i cili do të kërkojë që gjërat të rikthen si më parë.

PESHORJA
Mund t'ju vendosni një qëllim të ri vetes, por është shumë e vështirë që të realizohet. Mund të nisni shoqëri me një person të medias. Disa Peshore mund të vendosin të rregullojnë një konflikt me të cilin kanë kohë që përballen. Kjo do t'ju ndikojë mjaft mirë në ditën në vijim.

AKREPI
Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet të nxitojnë, pasi mund të gaboni gjatë punës. Do të shpenzojnë energji duke zgjidhur disa probleme në familjen tuaj. Në mbërmjen t'ju lini pas problemet dhe t'u përkushtoheni lidhjes suaj romantike.

SHIGJETARI
Mos refuzoni ndihmën e dikujt, pasi do t'ju ofrohet t'ju ndihmojë pa asgjë tjetër në këmbim. Rekomandohet të flisni hapur me dikë pranë jush. Martesa juaj mund të ngrejë pyetje, të cilat kërkojnë medoemos përgjigje.

BRICJAPI
Disa prej jush do të kalojnë një ditë të zakonshme. Mund të keni mosmarrëveshje me një prej kolegeve tuaj. Financat nuk do të jenë ashtu sikurse i prisnit. Megjithatë do të arrini të shlyeni një borxh të konsiderueshëm.

UJORI
Kjo ditë do të kalojë në ngrohtësi dhe në miqësi të mirë. Sot mund të krijoni një partneritet të mirë në biznes. Nuk rekomandohet që të bëni blerje të mëdha, mbi të gjitha artikuj luksozë. Do të kaloni një mbërmje të këndshme nën praninë e familjarëve tuaj.

PESHQIT
Mos u përpuniqni t'ju zgjidhni vetë problemet tuaja, por kërkoni edhe ndihmën e të tjerëve. Flisni hapur me njerëzit, pasi keni mundësi të bëni plot miq të rinj. Mund të bëni disa blerje, të cilat edhe pse të vogla do t'ua ndryshojnë ditën.

DERBI I KRYEQYTETIT

Tirana ka publikuar çmimet e biletave për derbin e madh të kryeqytetit, por ndryshe nga herët e tjera, kësaj radhe bardheblutë kanë vendosur që të printojnë vetëm biletat e tribunës përkarshi, duke mos hedhur në treg asnjë biletë për tribunën qendrore A dhe B, si dhe për anësohet H dhe C. Ky vendim kushtrëzon në fakt ti-



Tirana nxjerr në shitje biletat, por mban pezull ato për Partizanin

fozërinë e kuqe, e cila nuk do të ketë në dispozicion asnjë biletë, të paktën deri në ditën e mërkurë, sikundër njofton klubi bardheblu. Tirana mesa duket pret vendimin e Komisionit të Disiplinës dhe do të hedhë në treg dhe pjesën e biletave për tifozët e Partizanit, pasi

pjesa qendrore e tribunës, që i takon klubit pritisë zakonisht nuk del në treg. "Ditën e martë, pranë biletarist stadiumit 'Selman Stërmasi', dalin në shitje nga ora 10:00-18:00 biletat për ndeshjen e radhës KF 'Tirana' - KF 'Partizani', takim që do të luhet ditën e

premtë, në orën 18:00. Fillimisht do të shiten vetëm biletat për tribunat D, E, F dhe G. Tribunat A, B, C, H do të dalin në shitje ditën e mërkurë me një njoftim të dytë dhe për tifozërinë e Partizanit. Çmimet:

Tribuna A, B - 2000 lekë (të reja) Tribunat C, H, D, E, F, G - 400 lekë (të reja)", lexohet në njoftimin e klubit bardheblu.

CHAMPIONS LEAGUE

UEFA nis hetimin për Simeonen dhe Alegrin

Komisioni i Etikës dhe Disiplinës në UEFA ka hapur një hetim disiplinor në bazë të ngjarjeve të ndodhura gjatë ndeshjes mes Atletikos së Madridit dhe Juventusit më 20 shkurt. Natyrisht që për trajnerin bardhekuqve, Diego Simeonen, ishte e pritshme diçka e tillë pas gjestit që bëri në castin e shënimit të golit të dytë të tijve. Por jo vetëm Simeone, edhe Masimiliano Alegri ka përfunduar në lupën e etikës së UEFA-s, sipas së cilës trajneri bardhezi është përgjegjës për vonesën e daljes së ekipit në fushë pas pushimit të ndeshjes. Çështjet në fjalë do të shqyrtohen nga Zyra e Kontrollit pranë Etikës dhe Disiplinës së UEFA-s, ndërsa seanca dëgjimore mbetet ende për t'u përcaktuar.



Jeton Selimi

Kuqezinjët publikojnë listën e personave që kanë zyrtarizuar në Federatën Shqiptare të Futbollit

Flamurtari zë "mat" Partizanin: Interesohuni, pastaj reagoni!

Shkëlqim Ramaj figuron si pjesë e kuqezinjve

Pas reagimit të ultrasve të Partizanit, klubit të kuq dhe ultrasve vlonjatë, ka ardhur edhe reagimi i klubit të Flamurtarit. Me anë të një postimi në faqen zyrtare në rrjetet sociale kuqezinjët dënojnë ashpër dhunën e ushtruar ndaj fotografit nga ana e disa tifozëve të Partizanit, i cili mban edhe postin e zëdhënësit për shtyp të klubit vlonjat. Flamurtari vlerëson homologët kryeqytetas për distancimin nga dhuna e ushtruar dhe mohon çdo akuzë për provokim nga zyrtari i klubit të tyre. Justifikimi i klubit të kuq që theksoi se kishte një "mungesë totale të forcave të sigurisë" nuk ka nevojë për shumë koment sipas vlonjatëve. Partizani ishte klubi pritisë dhe rregullorja e përcaktuar që të përgjegjësia e organizimit të ndeshjes dhe mungesa e forcave të sigurisë në zona të caktuara të stadiumit është detyrë e klubit organizator të ndeshjes. "Nëse nuk do të merrnin masat e duhura, episodi i ndodhur mund të kthehej në precedent të rrezikshëm dhe ngjarje të tilla do të përsëriteshin edhe në stadiume të tjera të Shqipërisë, me justifikimin se 'ishin vetëm pak tifozë, nuk ka arsye për të na dënuar', përfundon reagimi i Flamurtarit. "Flamurtari Football Club ka qëndruar në heshtje deri tani, duke pritur dhe shpresuar që të jenë organet kryesore të Federatës Shqiptare të Futbollit, ato që vendosin në bazë të rregullores për ngjarjen e shëmtuar të së shtunës në 'Selman Stërmasi', ku u sulmua

Official website information for Flamurtari Football Club Vlorë, including contact details and a list of administrative staff for the 2017-2018 season.

ndeshjes. Për këtë arsye, nëse klubi Partizani është i paqartë për rolin e zyrtarit të sulmuar gjatë ndeshjes, bën mirë të interesohej dhe të marrë informacion zyrtar në FSHF, para se të bëjë reagime publike që tentojnë të largojnë vëmendjen nga thelbi i ngjarjes. Së dyti, 'personi me aparat fotografik' nuk ka luajtur asnjë rol aktiv duke provokuar tifozët. Nëse drejtuesit e Partizanit nuk e kanë këtë informacion, mund të shohin të gjitha ndeshjet e fundit të Flamurtarit dhe fotot e postuara në faqen zyrtare të klubit, për të kuptuar që pas çdo goli futbollistët kanë zgjedhur atë mënyrë festimi dhe kërkjojnë ata që të fotografohen ashtu, në njërin cep të fushës. Futbollistët nuk ishin drejtuar nga tifozëria e Partizanit, në atë kënd nuk kishte tifozë dhe nuk e kuptojmë ku qëndron provokimi, kur një grup tifozësh vrapojnë, ofendojnë dhe futen në fushë, vetëm e vetëm sepse një grup futbollistësh festojnë në mënyrën e tyre modeste një gol të shënuar. Klubi Partizani thotë se kishte 'mungesë totale të

forcave të sigurisë, të cilët janë përgjegjësit e vetëm për mbarëvajtjen e garës dhe moslejimin e këtyre provokimeve dhe incidenteve". Në lidhje me këtë pikë, besoj se nuk ka nevojë për shumë koment, sepse çdo njeri e di që me rregulloren klubi mikpritës mban përgjegjësi për mungesën totale të sigurisë në zona të caktuara të stadiumit dhe nuk mund të justifikohet në këtë mënyrë, duke akuzuar herë zyrтарin e klubit vizitor e herë forcat e sigurisë, që në fakt janë kontraktuar nga vetë klubi që organizon ndeshjen. Në këtë pikë, asnjë rregullorë në botë nuk merrret me forcat e sigurisë, të pakta apo të shumta qofshin, por me klubin, që ka dështuar në përmbushjen e përgjegjësive për organizimin e ndeshjes. Flamurtari shkoi në Tiranë për të luajtur një ndeshje normale futbollit, futbollistët dhe zyrtarët e saj nuk bënë asgjë për të shkatërruar mbarëvajtjen e ndeshjes dhe nuk është faj i Flamurtarit nëse siguria është në nivele minimale, apo se disa tifozë shkojnë në stadium për të shkaktuar dhunë, duke mos pranuar as golin dhe as festimin e një ekipi kundërshtar, që sillet në mënyrë perfekte në fushë e jashtë saj. Kemi respekt maksimal për çdo kundërshtar, respektojmë çdo rezultat që prodhon fusha, por nuk pranojmë që ngjarje të tilla të kalojnë në heshtje, edhe duke akuzuar pikërisht Flamurtarin si fajtor kur bie pre e dhunës, që për fat nuk degradoi në dhunë fizike ndaj futbollistëve tanë. Bëjmë thirrje që secili të marrë përgjegjësinë që i takon dhe organet zyrtare në Federatën Shqiptare të Futbollit të zbatojnë rregulloret si në çdo vend të zhvilluar dhe në çdo kampionat që ne synojmë të arrijmë në nivel futbollit e organizimit. Në rast se nuk do të ketë reagim të fortë për një ngjarje të tillë, atëherë është e qartë që krijohet një precedent i rrezikshëm dhe ngjarja e së shtunës mund të përsëritet në çdo stadium, ndërsa pas saj çdo klub do të justifikohet se 'ishin vetëm pak tifozë, nuk ka arsye për të na dënuar'".

KUPA E MBRETIT

Vinicius ndez "El Clasicon"-n: Mesi nuk frikëson askënd

"El Clasico" po vjen. Ndeshja më e rëndësishme e planetit do të zhvillojë ndeshjen e kthimit të vlefshme për Kupën e Mbretit dhe tifozët në mbarë globin po presin përballjen e dytë pas barazimit të ndeshjes së parë. Dhe, si për ta bërë më të shijshme këtë mbremje, është Vinicius Junior, ai që shton dozaz pikante në këtë përballje. Sulmuesi brazilian i Realit ka dhënë opinionin e tij, duke ngacmuar Mesin. "Mesi? Është i jashtëzakonshëm, por nuk frikëson njeri. Ai bën gjëra që s'i bën askush tjetër, por ne jemi skuadra më e mirë në botë. Mezi po e presim 'El Clasico'-on dhe të gjithë futbollistët duan ta luajnë me çdo kusht këtë ndeshje. Mja personalisht më pëlgen shumë. Duhet të luajmë si në 'Camp Nou', vetëm këstu mund të fitojmë. Kemi nevojë që tifozët të na mbështesin. Golat? Ka gjithnjë diçka që duhet përmirësuar dhe ky është objektivi im. Ajo që ka më shumë rëndësi është të fitojmë".

Paralajmëron presidenti bavarez

Hënes: Nuk paguaj 42 milionë për Hames nëse s'luan

Uli Hënes, presidenti i Bajernit të Mynihut, ka folur për Hames Rodrigëzin, lojtar që duket se po fiton një rol vendimtar në fushë, por ende jo në formacionin e trajnerit Robert Kovaç, i cili ka arritur të ngushtojë diferencën me Borussia Dortmundin në vetëm 3 pikë dhe tani është në vallet për titullin kampion. Por presidenti i bavarezëve, në prononcimin e tij, e ka lënë në ajër situatën e kolumbianit të ardhur me formulë huazimi nga Realit i Madridit. "E ardhmja e Hamesit varet nga trajneri. Nëse Kovaç nuk ka ndërmend ta përdorë, unë nuk kam ndërmend të paguaj 42 milionë euro. Nëse ai parashikon që ta aktivizojë më shpesh, do ta paguajmë kartonin e tij. Kemi të drejtën e blerjes, që mund ta përdorim deri në fund të majit, ende nuk kemi marrë një vendim".


Portieri s'pranoi zëvendësimin

Ish-kapiteni Terri sulmon Kepan: Nuk tregove respekt

Gjesti i portierit të Çelsit, Kepa Arrizabalagas, që nuk pranoi të zëvendësohej gjatë ndeshjes së djeshme mes skuadrës londineze dhe Manchester Sittit, ka tërbuar ish-kapitenin e bluve dhe të Kombëtares së Anglisë, Xhon Terrin. Terri ka komentuar çështjen 'Kepa-Sarri', duke i dërguar një mesazh të qartë portierit bask. "Kur del numri në tabelën elektronike, duhet të dalësh të tregosh një fije respekti", ka thënë ish-kapiteni për "Sky Sports". Ndërsa Kepa e ka komentuar kështu gjestin që bëri të gjithë botën e futbollit. "As nuk e kam cur ndërmend të mos i bindem zgjedhjes së trajnerit për të zëvendësuar. Ishte në keqkuptim, sepse më duhej të prisja një përgjigje nga mjekët, njëkohësisht me vendimin e Sarrit".




Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Salacrou dramaturg
 - Blair e Ekzorcistët.
 - I bylbylit ai i Mjedës.
 - Inicialet e Morricones
 - Gjysmë vektor.
 - Një port përballë Xhibutit.
 - Në mes të Salt dhe City.
 - Janë stacionet e beduinëve.
 - Një pjesë e taktikës.
 - Janë tifozë partie.
 - Janë firmat mashtruese.
 - Përpunojnë natfë.
 - Janë konservatorë.
 - Eshtë derri.
 - Një monedhë maqedonase.
 - Kufizojnë ambiente.
 - Inicialet e Gould aktor.
 - Fillojnë jetën.
 - Janë dëshmorët.
 - U shkrua nga Garcia Lorca.

- Janë baballarët.
 - Tregon çmimin dhe modelin.
 - Eshtë ujëvara.
 - Një mund të jetë mbi xhiro.
- VERTIKAL**
- Film i James Cameron.
 - Jeronim de i Milosaos.
 - Eshtë doktori me bluzë të bardhë.
 - Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
 - Janë si jerm.
 - Fillojnë lejen.
 - Klikohet me mouse
 - Një vegël.
 - Luftohet me kinina.
 - Janë cilësi.
 - Janë reaksionet në provuata
 - Një sportist që kërcen me shkop.
 - Janë tek në zhele
 - Eshtë kullë xhamie.
 - Bëhet një për zakon.
 - Gruaja e Fantozzi-t
 - Gjysmë afërsi.
 - Janë ndriçues.
 - Nuk duhet shkelur një i tillë.
 - U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
 - Një fjalë për goja.
 - Garbo e kinemasë.
 - Braktisi Didonën.
 - Me të bëjnë një thikë.
 - Mund të jetë gjaku.
 - Janë dhoma.
 - Ai dhe ajo.
 - Ushtria republikane irlandeze.
 - Agjenci Transporti Korçë.
 - Me stpon në box.
 - Inicialet e Moravia-s.


Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL**
- Ishtë babai i parë.
 - Indërmani progresistët.
 - Thyhet një me kohën më të mirë.
 - U braktis nga Helena.
 - Seritë pa zë.
 - Kryeqyteti i Kinës.
 - Ramazzotti këngëtar.
 - Janë sherre në shtyp.
 - Inicialet e Clapton.
 - Eshtë shuma e brinjëve të drejtëndëshit.
 - Një letrar është tregimi.
 - Fillojnë nazet.
 - Matet pa kufij.
 - Inicialet e Kokoschka piktor
 - Kufijonë mendimet.
 - Bergman që që aktore.
 - Eshtë shpërbilimi në para.

- Eshtë i keq.
 - Mund të kthehet në mllef.
 - Një pije piratësh.
 - Janë në fazë.
 - Fillojnë lejen.
 - U shkrua nga Theodore Dreiser.
 - Një... italiane.
 - Një verë në Paris.
 - Janë vende ku prehehen martirë.
 - Italia në Internet
- VERTIKAL**
- Wenger trainer.
 - Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
 - Një është edhe Bujar Lako
 - Fillojnë mobilizimin.
 - Institucione Rajonale Polake.
 - Një rapper i famshëm.
 - Kështu thirrje Ronaldo, bomber brazilian
 - Ndezur në aparatë.
 - Një film i ribërë.
 - Ekstre në model.
 - Dy asa.
 - Eshtë fytyra kamionit.
 - Mund të bëhet me medalje trimërie.
 - Mund të jenë të rastit.
 - E ka simbolin Tt.
 - Eshtë dëm, qeder.
 - Inicialet e Tappert.
 - Një pjesë e pejsazhit.
 - Ndahet në barazim.
 - Janë kandilë deti
 - Hayforth që që aktore
 - Eshtë enë për të skuqur.
 - Emri i Zola.
 - Gjysma e globit.
 - Janë në skaje.
 - Kryqteti i Letonisë.
 - Eva... Isabel Allende-s
 - Një stacion i famshëm orbital
 - Inicialet e Lennon.
 - Ditong në dует.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		3	5	8		6		
	8		4	6			9	1
6								
				1		8		
				2			1	
5	8							7
7	1	9						
	3		7			5	8	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	9	7	3	1	2	4	5	6
6	1	3	5	9	4	7	2	8
4	2	5	6	7	8	9	1	3
9	4	1	8	6	7	5	3	2
5	3	8	9	2	1	6	4	7
2	7	6	4	3	5	8	9	1
3	5	9	1	8	6	2	7	4
7	6	4	2	5	3	1	8	9
1	8	2	7	4	9	3	6	5

Argëtim filozofik

- Dashuria jonë është si një lumë. Gjatë rrjedhjes bëhet më i madh, dhe në fund humbet në det dhe bëhet një me pafundësinë.

- Kur gruaja është 18 vjeçe, është si një top futboll, 22 burra e ndjekin atë. Kur është 28, është si një top basketbolli, 10 burra e ndjekin.

- Kur është 38, është si një top golfi, vetëm një burrë merret me të. Kur është 48, është si një top ping pongu. 2 burra përpiqen t'ia shtynjë atë njëri-tjetrit.

- Është mirë të keni para dhe gjërat që paratë mund të blejnë, por është gjithashtu e rëndësishme të siguroheni që nuk keni humbur atë që paratë nuk mund të blejnë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

14	5	U	P	A	5	11	15	9	14	3	
2	8	2	9	2	6	15	9	2	17	11	
6	6	5	8	2	6	8	2	8	2	14	
11	4	12	2	7	6	2	11	2	3		
8	2	9	4	6	3	6	9	15	9	3	
9	9	3	3	2	12	4	7	3	2	14	
4	6	2	6	4	4	6	3	14	17		
8	5	13	19	4	9	3	3	15	6		
3	7	6	19	12	3	4	12	11	4		
6	3	9	2	13	4	6	9	3	12	2	6
4	13	6	3	6	2	13	3	11	4	4	
6	2	15		4	9	11	15	9	2	6	

B	A	S	T	E	T	P	A	P	A		
U	R	A	T	U	R	H	P	A			
S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I	
T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R	
B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T	
S	A	L	I	R	A	M	A	E			
G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R	
A	R	E	S	A	O	E	N	E			
Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T	
I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

K	R	E	S	F	D	E	T	I				
M	A	M	A	M	E	P	K	E	L			
A	M	I	S	I	M	O	N	I	A	B	O	
T	O	T	R	E	T	O	R	I	K	A		
E	N	O	K	D	O	M	A	T	E	L		
R	M	A	R	T	I	R	E	T	I	O		
I	A	R	A	T	O	N	E	R	R			
A	N	M	O	I	L	A	R	R	O	D		
L	E	A	D	M	A	L	I	A				
E	N	T	E	V	E	A	P	L	R			
A	R	M	A	N	I	A	N	D	E			
T	E	R	R	I	T	O	R	I	A	L	E	M
K	L	A	S	A	S	P	A	R	T	A	K	U
K	A	R	R	I	E	R	A	A	R	T		
M	E	R	C	E	N	A	R	A	R	O		
G	J	A	H	U	N	I	N	J	A			
J	I	T	U	G	S	U	M	O				
I	E	E	E	T	O	P	A	R				
F	I	A	T	M	S	B	R	O	T	A		
R	M	R	S	A	M	O	T	E	R	O		
O	B	E	R	O	N	M	I	A				
N	I	N	A	M	A	T	H	A	U			
T	A	S	T	I	R	O	I	D	E	T		
I	N	T	E	R	I	T	M	K	E	N		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Një nënë mund të ushqejë shtatë fëmijët e saj, ndërsa shtatë fëmijët nënën e tyre, jo.
- Vetëm ata që kanë guximin për të shkruar fjalën "Fund" mund të gjejnë forcën për të shkruar fjalën "Fillim" !!!
- Të bësh çfarëdo që të pëlgen, është lirë. Të të pëlqejë çfarëdo që bën, është sukses.
- Kurrë nuk do të arrini në destinacionin tuaj në qoftë se ndaloni dhe i gjuni me gurë çdo qeni që lehtë.

